# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6776
E mërkurë, 7 dhjetor 2022
çmimi 0.40 €


## Sali Berisha sulmohet gjatë protestës kundër qeverisë Rama

FAQE 5




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


MBAHET SAMITI I BASHKIMIT EVROPIAN (BE) DHE BALLKANIT PERËNDIMOR NË TIRANË

# SAMITI I TIRANËS: KRIZA E ENERGJISË, BE-ja ZOTON 1 MILIARD EURO PËR BALLKANIN

FAQE 5




Tirana ka qenë nikoqire e Samitit të Bashkimit Evropian (BE) dhe Ballkanit Perëndimor, në të cilin kanë marrë pjesë liderët kryesorë të BE-së, duke përfshirë kancelarin gjerman Olaf Scholz dhe presidentin francez Emmanuel Macron. Krahas diskutimeve për krizën energjetike, ku BE-ja është zotuar për ndarjen e 1 miliard eurove për Ballkanin, në këtë samit është firmosur edhe marrëveshja për heqjen e tarifave "Roaming". Me këtë rast, nikoqiri i Samitit BE - Ballkani Perëndimor, kryeministri Edi Rama, e ka quajtur ditë historike për Shqipërinë mbajtjen e këtij samiti

## PRISHTINA DHE BEOGRADI MARRIN TEKSTIN E PËRDITËSUAR TË PLANIT FRANKO-GJERMAN

FAQE 5



Përfaqësuesi i lartë i Bashkimit Evropian për politikë të jashtme dhe siguri, Josep Borrell, ka konfirmuar se Prishtina dhe Beogradi kanë marrë tekstin e përditësuar të të ashtuquajturit plan franko-gjerman për normalizimin e marrëdhënieve. Ndërkaq të martën kryeministri Albin Kurti ka pritur në takim përfaqësuesin e posaçëm të Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, me të cilin ka diskutuar rreth mbarëvajtjes dhe dinamizimit të procesit të dialogut



## KE-ja PRANON SE GABIMISHT KËRKOI QË SHTETET E RAJONIT T'I VENDOSNIN VIZA KOSOVËS

FAQE 3

## AKTUALE



### PESË SHPËRTHIME NDODHËN TË MARTËN NË VERI

F. 5

### GJATË VITIT 2022 U PARASHKRUAN RASTET E 28 TË AKUZUARVE PËR KORRUPSION

F. 6

### PËR KATËR VJET JANË MARRË 361 MASA DISIPLINORE NDAJ NËPUNËSVE CIVILË

F. 7



## EKONOMI



### TË PREMTEN LIGJI I PAGAVE SHQYRTOHET NË KUVEND

F. 8

### HOTI THOTË SE KA MENAXHIM KATASTROFAL TË PARASË PUBLIKE

F. 8

## SPORT



### KUKA: TRAJNERIN E SERBISË GATI E KAPI ZEMRA NGA SUKSESI I SPORTISTËVE SHQIPTARË

F. 10


RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

# Kryeprokurori i GjPN-së, kundër krijimit të gjykatës speciale për krimet në Ukrainë



**Hagë, 6 dhjetor** - Kryeprokurori i Gjykatës Penale Ndërkombëtare (GjPN) kundërshtoi një propozim të Bashkimit Evropian për të krijuar një gjykatë speciale, të mbështetur nga OKB-ja, për t'i ndjekur penalisht krimet në Ukrainë. Ai tha se GjPN-ja është e aftë t'i trajtojë në mënyrë efektive krimet e kryera atje.

Kryeprokurori Karim Khan kundërshtoi planin për të cilin presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, njoftoi javën e kaluar. Zyrtarja evropiane tha se duhet të krijohet një gjykatë speciale për ta ndjekur penalisht pushtimin rus të Ukrainës. "BE-ja e ka keqinterpretuar ligjin", u tha Khan gazetarëve, teksa shtoi se institucioni ku ai punon është i aftë të ndjekë penalisht figura të larta politike.

Gjykata Penale Ndërkombëtare, me seli në Hagë, ka nisur një hetim lidhur me krimet e luftës në Ukrainë, por ky institucion nuk mund ta ndjekë penalisht krimin e agresionit - akti i pushtimit të një shteti tjetër - sepse Federata Ruse nuk është nënshkruese e Statutit të Romës, një traktat që ka krijuar këtë gjykatë.

Në njoftimin e saj, von der Leyen tha se është thelbësore që të merret miratimi nga Kombet e Bashkuara në mënyrë që të shmangen problemet e imunitetit. Krerët shtetërorë, sikurse ai rus Vladimir Putin, në përgjithësi konsiderohen se janë imunë nga ndjekja penale për aq kohë sa janë në pozita shtetërore.

Von der Leyen tha se BE-ja do të punonte me partnerët ndërkombëtarë "për të marrë mbështetje sa më të madhe ndërkombëtare" për tribunalin dhe, po ashtu, do ta vazhdojë mbështetjen për GjPN-në.

Khan e pranoi se GjPN-ja nuk mund ta ndjekë penalisht Putinin për krim të agresionit, por figurat e nivelit të lartë mund të ndiqen penalisht për krime lufte apo gjenocid. "Ne duhet ta shmangim fragmentimin dhe në vend të kësaj të përqendrohemi në punën e konsolidimit", tha Khan gjatë adresimit para një trupi mbikëqyrës të gjykatës.

Qëkur Putini urdhëroi pushtimin e Ukrainës më 24 shkurt, forcat e tij ushtarake janë akuzuar për shkelje, duke filluar nga vrasjet në Buça e deri te sulmet vdekjeprurëse ndaj ndërtesave civile, përfshirë edhe bombardimin e teatrit në Mariupol më 16 mars, sulm në të cilin, sipas një hulumtimi të "Associated Press", janë vrarë afër 600 persona.

# Holanda kundër futjes së Bullgarisë në zonën Shengen

**Amsterdam, 6 dhjetor** - Kryeministri bullgar Galab Donev ka thënë se Holanda po kundërshtonte pranimin e Bullgarisë në zonën që mundëson udhëtimin pa pasaporta brenda Bashkimit Evropian që njihet si zona Shengen.

Blloku evropian ka 27 vende anëtare, por jo të gjitha janë pjesë e marrëveshjes së Shengenit.

Vendet anëtare të BE-së, Bullgaria, Kroacia dhe Rumania, po kërkojnë t'i bashkohen Shengenit dhe kanë nevojë për mbështetjen unanime të ministrave të brendshëm të BE-së në takimin që do mbahet më 8 dhjetor.

Kryeministri holandez ka përmendur shqetësimet se Bullgarisë i mungojnë rregulla efektive për ta luftuar korrupsionin.



Kryeministri bullgar tha se vendi i tij përmbushi të gjitha kërkesat për t'iu bashkuar Shengenit dhe kundërshtimi mund të krijojë ndarje brenda BE-së. Ai i quajti rezervat e Holandës "standard të dyfishtë". "Në ditët në vijim qeveria do ta vazhdojë punën e saj aktive me partnerët për ta siguruar pranimin e Bullgarisë në Shengen. Në të njëjtën kohë, në varësi të rezultatit, qeveria do të vendosë për përgjigjen adekuate përfshirë miratimin e kundërmasave", tha ai.

Austria ka thënë se kundërshton zgjerimin e Shengenit me Bullgarinë dhe Rumaninë duke përmendur mbrojtjen e kufijve të jashtëm të BE-së. Ajo ka thënë se numri i emigrantëve të ardhur që kalojnë nëpër këto vende do të duhet të bjerë që ajo të pajtohet me zgjerimin e Shengenit.

Komisionarja e çështjeve të brendshme të BE-së, Ylva Johansson, tha se Bullgaria, Rumania dhe Kroacia i përmbushin të gjitha kërkesat e Shengenit. Të gjitha raportet "bëjnë të qartë se Bullgaria, Rumania dhe Kroacia përmbushin plotësisht të gjitha kërkesat për të qenë anëtarë të plotë të Shengenit. Ky është ai që pres të jetë rezultati i Këshillit të enjten", tha ajo në Bruksel të hënën. Megjithatë, presidenti i Këshillit Evropian, Charles Michel, në një intervistë që u botua të hënën në të përditshmen çeke "Hospodarske Noviny", tha se debati për këtë mund të ndikohet nga vazhdimi i sulmeve të reja ruse me raketa në Ukrainë dhe rreziku i një vale të re refugjatësh si rezultat i kësaj. "Unë isha më optimist para disa muajsh për marrëveshjen... Tani që duhet të merret vendim, atmosfera është ndryshe", citohet të ketë thënë ai.

# Rusia do t'i shesë karburant me çmime të ulëta Pakistanit

**Moskë, 6 dhjetor** - Pakistani ka njoftuar se Rusia ka vendosur të eksportojë karburant të papërpunuar, naftë dhe benzinë me çmime të ulëta drejt këtij vendi të Azisë Jugore.

Zëvendësministri për Karburantet, Musadik Malik, i bëri me dije detajet në një konferencë për medie në Islamabad, pasi vizitoi Moskën javën e kaluar, ku u takua me homologët rusë. "Një delegacion ndërqeveritar i udhëhequr nga ministri rus i Energjetikës do ta vizitojë Pakistanin muajin e ardhshëm dhe do t'i përcaktojmë detajet për të cilat ju informova, në mënyrë që të nënshkruajmë një marrëveshje për të blerë karburant të papërpunuar, naftë dhe benzinë me çmime të ulëta", tha Malik.

Ai nuk i bëri me dije detajet e mëtejshme si, p. sh., për llojin e uljes në çmim që do të ofrojë Moska, apo se kur mund të fillojë Islamabadi të importojë produkte hidrokarbure nga Rusia. "Ulja do të jetë njësoj si uljet që u ofrohen vendeve të tjera në botë", tha Malik.

Ai tha se bisedimet "kishin rezultuar më produktive se ç'pritej" dhe se u nxitën nga "interesi kombëtar" i Pakistanit, që e detyron qeverinë ta mbushë boshllëkun e krijuar nga mungesa e furnizimit me energji, në të gjitha mënyrat e mundshme.

Malik tha se Pakistani është, gjithashtu, i interesuar për ta blerë gazin e lëngshëm natyror (LNG), por se rezervat e kompanive shtetërore ruse janë të pakta në këtë moment.



EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# Prishtina dhe Beogradi marrin tekstin e përditësuar të planit franko-gjerman



**Përfaqësuesi i lartë i Bashkimit Evropian për politikë të jashtme dhe siguri, Josep Borrell, ka konfirmuar se Prishtina dhe Beogradi kanë marrë tekstin e përditësuar të të ashtuquajturit plan franko-gjerman për normalizimin e marrëdhënieve. Ndërkaq të martën kryeministri Albin Kurti ka pritur në takim përfaqësuesin e Posaçëm të Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, me të cilin ka diskutuar rreth mbarëvajtjes dhe dinamizimit të procesit të dialogut**

EPOKA E RE Mal QORRAJ

Prishtinë, 6 dhjetor - Kryeministri Albin Kurti ka pritur në takim përfaqësuesin e posaçëm të Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak.

Mbarëvajtja dhe dinamizimi i procesit të dialogut ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë, elementet e kornizës themelore të marrëveshjes, zhvillimet e fundit në Kosovë dhe çështje të tjera aktuale ishin temat kryesore të takimit.

Kryeministri Kurti e falënderoi Lajçakun për angazhimin e tij në dialog, ndërsa ritheksoi elementet e kornizës së marrëveshjes për normalizimin e plotë të raporteve me njohjen reciproke në qendër. Ai e njoftoi Lajçakun që qeveria është në përfundim të përgatitjeve për aplikimin e Republikës së Kosovës për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Kryeministri Kurti ritheksoi se qeveria është e vendosur për sundimin e ligjit dhe e përkushtuar për ruajtjen e paqes dhe sigurisë në Republikën e Kosovës.

I dërguari i posaçëm i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Mirosllav Lajçak, ka theksuar se zyrtarët në Bruksel janë duke punuar që takimi i radhës në mes të kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, dhe presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, të mbahet brenda javësh. “Mund të kthehem sërish së shpejti për t’u siguruar që takimi [Kurti - Vuçiq] do të jetë i përgatitur mirë. Besojmë se nuk ka më kohë për të humbur”, ka thënë Lajçaku pas takimit me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti.

Të martën shefi i politikës së jashtme i BE-së, Josep Borrell, ka thënë se dy vendet kanë marrë tashmë tekstin e përditësuar të të ashtuquajturit plan franko-gjerman, që parasheh disa hapa për normalizimin e marrëdhënieve mes tyre. “Versioni i fundit i tekstit është dërguar dje në Beograd dhe sot në Kosovë. Ato [Kosova dhe Serbia] duhet të angazhohen tani në një diskutim serioz, sepse ky është një moment, ku ka një mundësi të madhe”, ka deklaruar Borrelli në Tiranë, ku po merr pjesë në një samit midis BE-së dhe përfaqësuesve të vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Plani i BE-së, i cili mbështetet nga Gjermania, Franca dhe Shtetet e Bashkuara, është pjesë e dialogut për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Ndonëse ka kohë që përflitet, për përmbajtjen e tij nuk ka informacione zyrtare.

Zëvendëskryeministri i Kosovës, Besnik Bislimi, ka thënë të martën se përmbajtja e planit nuk mund të bëhet publike në mënyrë që diskutimi për të “të jetë sa më konstruktiv”. Ai i bëri komentet në një takim të Komisionit për Punë të Jashtme dhe Diasporë të Kuvendit të Kosovës.

Më herët, zyrtarë në Kosovë e kanë cilësuar planin e ashtuquajtur franko-gjerman si “bazë të mirë” për diskutime të mëtejme me Serbinë, ndërsa në Serbi kanë thënë se plani nuk është në favor të saj.

Presidenti serb Aleksandër Vuçiq ka thënë se plani parasheh që Serbia të mos e pengojë Kosovën nga anëtarësimi në organizata ndërkombëtare, përfshirë Kombet e Bashkuara në këmbim të përshpejtimit të anëtarësimit të saj në BE.

Portali informativ Euractiv publikoi më 9 nëntor një dokument, për të cilin tha se është draft i propozimit franko-gjerman.

Dokumenti i publikuar përmban 9 nene. Fillon me pajtim për marrëdhënie normale në mes të Kosovës dhe Serbisë, angazhimin për integrim në BE, zgjidhjen e mospajtimeve dhe respektimin e integritetit territorial, respektimin e subjektivitetit të njëra-tjetrës, respektimin e ndërsjellë të juridiksionit, zotimin për rritje të bashkëpunimit në fusha të ndryshme - përfshirë ekonominë, shkencën, gjyqësorin, fushën e mbrojtjes etj. Plani, siç thuhet, parasheh edhe shkëmbimin e misioneve të përhershme, si dhe pajtimin e palëve që kjo marrëveshje nuk ndikon në marrëveshjet e arritura më parë.

Lajçak, një ditë më herët, qëndroi edhe në Beograd, ku takoi presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq. Ai ka thënë se në këtë takim, mes të tjerash, u diskutua për çështjen e kthimit të serbëve në institucionet e Kosovës.

Serbët e pjesës veriore i kanë braktisur institucionet e Kosovës në fillim të nëntorit për shkak të një vendimi të Qeverisë së Kosovës për t’i riregjistruar makinat me targa ilegale serbe në veri.

Kosova dhe Serbia, ndërkohë, kanë arritur një marrëveshje për çështjen e targave, por se si mund të kthehen serbët në institucione, tash për tash, nuk është e qartë.

Vuçiqi, në anën tjetër, tha se ka theksuar edhe një herë domosdoshmërinë e formimit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë.

Ky asociacion është pjesë e një marrëveshjeje që Kosova dhe Serbia kanë arritur në vitin 2013, por ajo nuk është zbatuar kurrë. Kurti thotë se në Kosovë nuk mund të ketë asociacion njëetnik, ndërsa Serbia insiston në krijimin e tij. Komuniteti ndërkombëtar, përfshirë BE-në dhe ShBA-në, u bën vazhdimisht thirrje palëve që t’i zbatojnë të gjitha marrëveshjet e arritura. Kurti dhe Vuçiqi u takuan për herë të fundit në nëntor, kur bisedimet u përqendruan në gjetjen e zgjidhjes për targat.




MBAHET SAMITI I BASHKIMIT EVROPIAN (BE) DHE BALLKANIT PERËNDIMOR NË TIRANË

# Samiti i Tiranës: Kriza e energjisë, BE-ja zoton 1 miliard euro për Ballkanin

Tirana ka qenë nikoqire e Samitit të Bashkimit Evropian (BE) dhe Ballkanit Perëndimor, në të cilin kanë marrë pjesë liderët kryesorë të BE-së, duke përfshirë kancelarin gjerman Olaf Scholz dhe presidentin francez Emmanuel Macron. Krahas diskutimeve për krizën energjetike, ku BE-ja është zotuar për ndarjen e 1 miliard eurove për Ballkanin, në këtë samit është firmosur edhe marrëveshja për heqjen e tarifave "Roaming". Me këtë rast, nikoqiri i Samitit BE - Ballkani Perëndimor, kryeministri Edi Rama, e ka quajtur ditë historike për Shqipërinë mbajtjen e këtij samiti

EPOKA E RE Lirim GECI

TIRANË, 6 DHJETOR - Në kryeqytetin e Shqipërisë, Tiranë, të martën është mbajtur Samiti i Bashkimit Evropian (BE) dhe Ballkanit Perëndimor. Në këtë samit kanë marrë pjesë përfaqësuesit kryesorë të Evropës dhe Ballkanit Perëndimor, duke përfshirë kancelarin e Gjermanisë dhe presidentin e Francës, Emmanuel Macron. Në Samitin e Bashkimit Evropian dhe Ballkanit Perëndimor ka marrë pjesë edhe presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani.

Krahas krizës energjetike, në këtë samit është firmosur marrëveshja për heqjen e tarifave "Roaming". Po në këtë samit janë zotuar 1 miliard euro për Ballkanin Perëndimor. Me këtë rast, nikoqiri i Samitit BE - Ballkani Perëndimor, kryeministri Edi Rama, në një konferencë të përbashkët për medie me dy zyrtarët kryesorë të BE-së, Charles Michel dhe Ursula von der Leyen, e ka quajtur ditë historike për Shqipërinë mbajtjen e këtij samiti.

Më tutje, Rama ka thënë se kanë marrë mbështetje buxhetore prej 85 milionë eurosh nga Bashkimi Evropian për energjinë. "Po kështu një tjetër gjë fantastike që diskutuam dhe kemi marrë mbështetje në parim si të presidentit të Këshillit dhe të presidentes së Komisionit dhe, mesa kuptoj, edhe mbështetjen e plotë të udhëheqësve, është për të punuar për të pasur në Tiranë kampusin e kolegjit të Evropës në Bryzh. Është një universitet me një reputacion mjaft të lartë, me kampusin e parë në Poloni më 1992 për t'i mbështetur vendet ish-komuniste për të hyrë në BE e tashmë është koha që këtë kampus ta ngremë në Tiranë. Është fantastike. Jo më pak është marrëveshja për roaming. Qytetarët tanë këtu e atje do të kenë mundësi së shpejti të kenë tarifa që janë shumë më të ulëta dhe që do ta mundësojnë hyrjen në rrjetin e qytetarëve evropianë. Për ta përmbyllur me atë çka është më e rëndësishmja, energjinë, kemi marrë tanimë nga BE-ja përmes Komisionit mbështetje buxhetore për vitin në vijim, 85 milionë euro, por në të njëjtën kohë ka një paketë tjetër për projekte dhe tanimë kemi projektet tona. Rajoni do të jetë i gjithi i përfshirë në këtë rrugëtim për të ndërtuar më shumë burime energjie dhe për t'u distancuar gjithmonë e më shumë nga ndikimi rus. Mund të flisja shumë më gjatë, por dua të ndalem këtu", ka thënë Rama.

### 1 miliard euro mbështetje për energjinë

Ndërsa presidentja e Komisionit Evropian (KE), Ursula von der Leyen, pasi ka vlerësuar mirëpritjen e bërë në Tiranë nga kryeministri Edi Rama, ka thënë se Samiti në mes të BE-së dhe Ballkanit Perëndimor ka qenë fantastik. Duke folur për temat që janë diskutuar në mes të liderëve, Von der Leyen, ajo ka prekur sektorin e energjisë si një ndër më të rëndësishmit. Për këtë, ajo ka thënë se KE-ja ka një paketë prej 1 miliard eurosh mbështetje për Ballkanin Perëndimor që është e ndarë në dy pjesë. "Një temë madhore është që ne dëshirojmë të përballemi me sfidat që vijnë jo vetëm nga kjo luftë që ka nisur Rusia në Ukrainë, por edhe një nga pasojat e saj që ka të bëjë me sektorin e energjisë. Për ne është e rëndësishme që së bashku me miqtë tanë nga



# Veteranët paralajmërojnë protesta nëse nuk përfshihen në pagën minimale



Prishtinë, 5 dhjetor - Ushtruesi i detyrës i Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Faton Klinaku, ka thënë se nëse në Kuvendin e Kosovës del në lexim Projektligji për Pagën Minimale, atëherë do të protestojnë. "Përsëri filluan sot që t'i bëjnë temë veteranët e që, për mendimin tim, kjo bëhet vetëm për vota, prandaj nuk duhet t'u besohet. Sa i përket asaj se si qeveri paskan bërë disa hapa që të vijnë në një gjuhë të përbashkët me shoqatat e dala nga lufta dhe subjektet opozitare, absolutisht nuk është e vërtetë, sepse që nga shkresa e dërguar te kryeministri Kurti, nuk ka pasur më asnjë kontakt në mes nesh e rreth kësaj teme", ka thënë Klinaku.

Ai u ka bërë thirrje veteranëve, invalidëve e familjeve të dëshmorëve të jenë të gatshëm për protesta. "Sa i përket çfarëdo ligji të ri për veteranët, apo amendamentim të ligjeve aktuale në fuqi, këtë gjë e kemi thënë se kur dhe si mund të bëhet kjo, në shkresën tonë drejtuar qeverisë, prandaj po e publikoj edhe një herë shkresën që të mos manipulohet publiku. Nëse e kanë qëllim që të përgatitet apo manipulohet publiku e pastaj të dalë në Kuvend për lexim të dytë projektligji që i heq veteranët nga paga minimale, e them përsëri se ne do të jemi në protesta në oborr të Kuvendit. Veteranë të nderuar, invalidë e familje të dëshmorëve, të jeni të përgatitur që, nëse ju thërrasim në protestë, të dilni sa më masivisht", ka thënë Klinaku.

## Sali Berisha sulmohet gjatë protestës kundër qeverisë Rama

Tiranë, 6 dhjetor - Opozita në Shqipëri ka protestuar të martën kundër qeverisë të kryeministrit Edi Rama, në kohën kur në Tiranë është mbajtur samiti BE - Ballkani Perëndimor. Të thirrur nga Partia Demokratike dhe Partia e Lirisë, qytetarët janë mbledhur në bulevardin "Dëshmorët e Kombit", aty ku policia kishte vendosur perimetrin e sigurisë për ta garantuar qetësinë dhe sigurinë për mbarëvajtjen e samitit, që mblodhi liderët e Bashkimit Evropian dhe ata të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Protesta nisi me një incident. Sapo doli nga selia e Partisë Demokratike, kreu i këtij subjekti, Sali Berisha, u godit nga një qytetar me grusht në fytyrë.

Ekipi i sigurisë së Berishës arriti ta ndalte personin që policia e identifikoi si Gert Shehu. Më pas ai u shoqërua nga zyrtarët e rendit.

Pavarësisht këtij incidenti dhe shenjave të dukshme në fytyrë të shkaktuara nga sulmi, Berisha vijoi të ecte drejt vendit ku ishte ngritur podiumi i protestës.

Berisha i kërkoi policisë që ta lirojë personin që e sulmoi. "Ai është një fatkeq që ka shitur veten. Ka vetëm një autor të vërtetë dhe ai është Edi Rama", tha Berisha.

Berisha, po ashtu, theksoi se, "fatkeqësisht, në samitin me Bashkimin Evropian, Shqipëria përfaqësohet nga një kryeministër që duhet të ishte para drejtësisë". Ai e akuzoi Ramën se ka blerë bizneset dhe mediet dhe një pjesë të opozitës. "Rama ka futur në rrjetën e tij edhe



ambasadorët e huaj, që po sillen si guvernatorë. Ftoj mediet e huaja të hetojnë sepse do të ndihmojnë një popull që vuan nga korrupsioni i qeverisë Rama. Shqiptarët po ikin me gomone, sepse po vidhen çdo ditë nga qeveria e tyre", tha kreu i PD-së.

Berisha tha se mesazhi i tij për liderët evropianë është se në Shqipërinë e vërtetë, në pushtet "është mafia". "Sot në këtë samit merr një goditje fatale nisma e Ramës 'Ballkani i hapur'", tha Berisha duke iu referuar nismës rajonale, ku bëjnë pjesë Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Serbia. Protesta e opozitës u mbajt jashtë perimetrit të sigurisë, të vendosur nga autoritetet për shkak të samitit BE - Ballkani Perëndimor.

Fillimisht, dy partitë opozitare kishin thënë se do të protestonin para qeverisë dhe në vendin ku u mbajt samiti.

Policia e shtetit ndërmori masa të larta sigurie në bashkëpunim edhe me ekspertë të sigurisë së vendeve të BE-së si dhe me organizatat ndërkombëtare Interpol dhe Europol për ta garantuar sigurinë e 32 delegacioneve shtetërore të BE-së dhe Ballkanit Perëndimor dhe mbarëvajtjen e samitit.

Ballkani Perëndimor ne përballemi me këtë sfidë së bashku, në mënyrë të tillë, ku ne reflektojmë gjithçka që do të bëjmë ne në BE, reflektohet edhe këtu në Ballkanin Perëndimor. Për shembull, fakti që familjet dhe bizneset këtu do të kalojnë po aq vështirë sa do të kalojmë edhe ne për ne është e rëndësishme që të japim zgjidhje të njëjta, prandaj kjo paketë prej 1 miliard eurosh për mbështetje për sektorin e energjisë është e ndarë në 2 pjesë. 500 milionë euro mbështetje e drejtpërdrejtë buxhetore, e cila jep mundësinë në mënyrë që në formë të shënjestruar t'u jepet ndihmë familjeve në nevojë si dhe bizneseve në nevojë. Ndërsa gjysma e dytë, 500 milionë euro të tjera, janë mbështetje për infrastrukturën në mënyrë që të bëhet e pamundura që të bëhen investime për energjinë e së ardhmes, sepse energjia e së ardhmes është energjia e rinovueshme, është më pak e kushtueshme, më e gjelbër për planetin dhe prodhohet këtu në vendet tona. Jep dhe vende të reja pune dhe krijon pavarësinë nga varësia që ka qenë e mëparshme", ka thënë ajo.

Në anën tjetër, presidenti i Këshillit Evropian, Charles Michel, ka thënë se në Samitin e Tiranës është shkruar historia, pasi për herë të parë një samit i tillë është zhvilluar në Ballkan. Ai ka theksuar se e ardhmja e fëmijëve është më e sigurt dhe më e begatë me Ballkanin Perëndimor brenda BE-së. "Do të filloj duke falënderuar ngrohtësisht Ramën për mikpritjen. Mbledhje historike ku shkruam historinë. Shkruajmë historinë sepse për herë të parë u organizua në Ballkanin Perëndimor. Kjo mbledhje e sotme është deklarata që shoqëron punimet tuaja. Është e rëndësishme sepse përmban hapa shtesë në rrugën e integrimit. Kam pak emocion që jam në këtë tribunë në Tiranë. Besoj se e ardhmja e fëmijëve tanë do të jetë më e sigurt dhe më e begatë me Ballkanin Perëndimor brenda BE", ka thënë Michel.

Sipas Michel, BE-ja duhet ta përforcojë kapacitetin për ta përforcuar tregun e përbashkët rajonal. "Ideja e roamingut është një hap përpara në vijim të samitit të Brdos ku lindi kjo ide", ka thënë ai, duke shtuar se ka progres për t'u përballur me pasojat e luftës së Rusisë në Ukrainë. "Progres konkret është realizuar për t'i përballuar së bashku pasojat negative të sulmit të Rusisë ndaj Ukrainës. Kjo luftë ka pasur pasoja të rënda në energji, në fushën ekonomike dhe në fushën e furnizimit me ushqim", ka thënë Michel.

Pas përfundimit të këtij samiti është publikuar edhe një deklaratë e përbashkët. Në këtë deklaratë, Bashkimi Evropian ka kërkuar nga Kosova dhe Serbia marrëveshje dhe respektim të marrëveshjeve të kaluara. Po në këtë deklaratë janë përmendur një numër i madh çështjesh që kanë të bëjnë me Ballkanin Perëndimor dhe perspektivën evropiane të tij.

# Gjatë vitit 2022 u parashkruan rastet e 28 të akuzuarve për korrupsion



PRISHTINË, 6 DHJETOR - Në kuadër të Javës Kundër Korrupsionit, Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka organizuar tryezë të rrumbullakët, në të cilën ka prezantuar raportin me titull "Parashkrimi i Korrupsionit", i cili është rezultat i monitorimit sistematik që IKD i bën sistemit gjyqësor dhe atij prokurorial të Republikës së Kosovës.

Hulumtuesi i IKD-së, Lavdim Makshana, ka thënë se parashkrimi i rasteve të korrupsionit, por edhe lëndëve të natyrave të tjera, është një ndër shqetësimet kryesore të sistemit të drejtësisë tash e disa vjet. Ai ka thënë se kjo dukuri ka vazhduar edhe në vitin 2022 dhe ka rrezik potencial që të vazhdojë edhe gjatë vitit 2023. Sipas tij, faktorët të cilët kanë ndikuar në arritjen e parashkrimit janë: mosprocedimi i lëndëve gjyqësore brenda afateve të përcaktuara me ligj, shtyrja e seancave gjyqësore, numri i madh i lëndëve, ndërrimi i shpeshtë i trupave gjykuese, mungesa e gjyqtarëve, si dhe mungesa e stafit administrativ. Po ashtu, deklaroi se faktor tjetër që po ndikon në arritjen e parashkrimit është edhe kthimi i shpeshtë i rasteve në rigjykim, duke shtuar se ka shumë raste që kthehen në rigjykim dhe afatet kur kthehen në rigjykim janë shumë të gjata.

Ai ka theksuar se vetëm gjatë vitit 2022 janë parashkruar rastet ndaj 28 të pandehurve të akuzuar për korrupsion. Këta 28 persona bëjnë pjesë në gjithsej 16 raste. "Dëmi, sipas Prokurorisë, në këto raste fillon nga 5 euro deri në 5.4 milionë euro. Nëse kalkulohet dëmi i pretenduar nga Prokuroria në këto raste, i bie se vetëm brenda vitit 2022 janë parashkruar rastet e korrupsionit, dëmi në të cilat kalon vlerën prej 6 milionë eurove. Madje kjo vlerë llogaritet të jetë vetëm për 11 raste të korrupsionit, pasi në pesë raste të tjera Prokuroria nuk e ka përcaktuar dëmin në aktakuzë. Përjashtimisht tri rasteve, të gjitha aktakuzat e parashkruara gjatë vitit 2022 janë raste kur koha e kryerjes së veprës penale është viti 2012. Ndaj dy prej personave të akuzuar për korrupsion, rastet e të cilëve janë parashkruar, aktakuza ishte ngritur në vitin 2012, ndaj dy personave në vitin 2013, ndaj një personi në vitin 2014 derisa në shumicën e rasteve (ndaj 9 personave) aktakuza është ngritur në vitin 2015", ka thënë ai.

Makshana ka thënë se përtej vitit 2022 problemi i parashkrimit të korrupsionit duket se do të jetë evident edhe në vitet pasuese. Ai ka thënë se dhjetë të akuzuar në rastet e profilit të lartë të korrupsionit rrezikojnë të mbesin pa një vendim meritor për faktin se rastet e tyre parashkruhen në tri vitet e ardhshme, shtatë prej tyre gjatë vitit 2023.

Vilard Bytyqi, anëtar i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), ka thënë se në vitin 2022, në krahasim me vitet e kaluara, ka pasur një rritje të mbikëqyrjes dhe të administrimit të këtyre rasteve nga ana e Këshillit Gjyqësor.

# LPK-ja dha kontribut të jashtëzakonshëm në çështjen shqiptare




SKENDERAJ, 6 DHJETOR - Në sallën e Kuvendit Komunal të Skenderajt është mbajtur një akademi mirënjohjeje nga Lëvizja Popullore e Kosovës në bashkëpunim me komunën e Skenderajt, në 40-vjetorin e themelimit të LPK-së, në të cilën kanë marrë pjesë kryetari Fadil Nura, nënkryetari Sami Lushtaku, udhëheqësit e kësaj lëvizjeje, ish-të burgosur politikë, aktivistë të çështjes shqiptare dhe të ftuar të tjerë.

Në fjalën e tij para të pranishmëve, kryetari Nura, duke përshëndetur këtë akademi, ka thënë se Lëvizja Popullore e Kosovës që nga themelimi i saj në vitin 1982 ka dhënë kontribut të jashtëzakonshëm sa i takon çështjes shqiptare, me aktivitetin e saj jo vetëm në Kosovë, por edhe në të gjithë vendet ku kishte shqiptarë.

Me një fjalë në akademi është paraqitur edhe Jakup Nura, bashkëluftëtar i komandantit legjendar Adem Jashari, gjeneral i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, bashkëthemelues i UÇK-së i grupit të Drenicës dhe pjesë e Lëvizjes Popullore të Kosovës, i cili ka folur për organizimet dhe aktivitetet që kishte ndërmarrë kjo lëvizje për ta sensibilizuar çështjen kombëtare deri në formimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Ndërkaq, Ramadan Avdiu, një nga udhëheqësit e LPK-së, lexoi një kumtesë, në të cilën solli kronologjinë historike të ngjarjeve dhe aktiviteteve të organizuara ndër vite.

Edhe Murat Musliu, ish i burgosur politik, u paraqit me një fjalë rasti, duke sjellë në kujtesë ngjarjet e periudhave të vështira të popullit të Kosovës dhe kohën sa kishte qëndruar në burg për arsye politike.

Kurse në fund të kësaj akademie u dhanë mirënjohje për disa nga aktivistët e LPK-së dhe ish-të burgosurit politikë.

## Drenas, nënshkruhen kontratat me 200 studentë përfitues të bursave

DRENAS, 6 DHJETOR - Studentët nga Drenasi, përfitues për vitin akademik 2022/2023, kanë nënshkruar kontratat për marrjen e bursës komunale. Me rastin e nënshkrimit të kontratave, ka marrë pjesë edhe kryetari i komunës, Ramiz Lladrovci, i cili ka bërë nënshkrimin e kontratave për 200 bursa të nivelit të studimeve bachelor.

Gjatë nënshkrimit të kontratave me studentët përfitues, kryetari Lladrovci tha se ndihet krenar me numrin e madh të të rinjve të cilët kanë interesim kaq të madh për të studiuar.

Lladrovci ka shtuar se arritja e të rinjve në fushën profesionale në studime është arritje edhe e familjes dhe komunës së Drenasit. "Ju përgëzoj që jeni fitues i bursës, sepse e meritoni, pasi që i keni plotësuar kriteret e konkursit. Komuna e Drenasit vazhdimisht ka qenë e angazhuar për përkrahjen tuaj në fushën e dijes. Kemi rritur numrin e studentëve përfitues nga viti në vit dhe do ta vazhdojmë këtë traditë", ka thënë kryetari Lladrovci.



# Për katër vjet janë marrë 361 masa disiplinore ndaj nëpunësve civilë

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË 6 DHJETOR - Lëvizja Fol, në kuadër të "Javës Kundër Korrupsionit 2022", ka mbajtur konferencë për medie, me ç'rast ka publikuar raportin "Masat disiplinore kundër nëpunësit civilë për korrupsion dhe shkelje etike".

Kosova ka krijuar një kornizë të fuqishme ligjore dhe institucionale për ta forcuar etikën në administratën publike dhe shërbimin civil.

Ligji për Zyrtarët Publikë i ndan shkeljet disiplinore në dy kategori: shkelje të rënda dhe të lehta. Shkeljet e rënda konsiderohen: mospërmbushja e detyrave të punës; mosrespektimi i afateve të përcaktuara për kryerjen e detyrave.

Burbuqe Kastrati ka thënë se ky raport ofron një pasqyrë të të dhënave të publikuara nga Qeveria e Kosovës në lidhje me masat disiplinore të marra ndaj nëpunësve civilë për shkelje të etikës dhe legjislacionit kundër korrupsionit nga viti 2017 deri në vitin 2021.

Sipas Kastratit, bazuar në këto të dhënat nga Qeveria e Kosovës, për pesë vjetët e fundit, përkatësisht nga viti 2017 deri në vitin 2021, vlerësohet se janë marrë 361 masa disiplinore ndaj nëpunësve civilë, ose mesatarisht 72 masa disiplinore në vit.

Ndërkaq sa i përket llojit të shkeljeve të kryera, rezulton se ndaj nëpunësve civilë janë marrë 258 masa disiplinore për shkelje të rënda, ku përfshihen edhe rastet e korrupsionit, ndërsa 103 masa për shkelje të lehta. Shprehur në përqindje, del se 71 për qind e të gjitha shkeljeve të kryera nga viti 2017 deri në vitin 2021 përfshinin shkelje të rënda, tha ajo.

Sa i përket asaj se a janë shkelës më të mëdhenj në shërbimin civil të Kosovës burrat apo gratë, sipas të dhënave, del se burrat janë kampionët e shkeljes së etikës dhe legjislacionit kundër korrupsionit. Bazuar në të dhënat e disponueshme, gjatë pesë vjetëve të fundit pjesa më e madhe e masave disiplinore janë marrë ndaj meshkujve (171) krahasuar me vetëm 26 gra.

Në përqindje kjo tregon se 87 për qind e të gjitha shkeljeve në shërbimin civil të Kosovës janë kryer nga meshkujt.

Institucionet nga niveli qendror i qeverisjes, si ministritë dhe agjencitë ekzekutive, kanë një numër më të madh të rasteve të shkeljes së legjislacionit të etikës dhe ligjit antikorrupsion në krahasim me nivelin komunal.



Në bazë të të dhënave të disponueshme nga viti 2017 deri në vitin 2020, del se 63 për qind e masave të raportuara ndaj nëpunësve civilë për shkelje të etikës dhe legjislacionit kundër korrupsionit vijnë nga institucionet e nivelit qendror, tha Kastrati.

Nga të dhënat e këtij raporti del se qeveria duhet ta përmirësojë transparencën dhe raportimin për zbatimin e dispozitave të Kodit të Procedurës Penale për rastet kur zyrtarët publikë janë pezulluar për shkak të hetimeve për korrupsion.

Në këtë kontekst dhe, po ashtu, shumë e rëndësishme për luftën kundër korrupsionit është monitorimi efektiv i zbatimit të nenit 62 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës i cili u mundëson gjykatave që "ta ndalojnë kryerësin që të ushtrojë funksione në administratën publike ose në shërbimin publik për një deri në pesë vjet pas vuajtjes së dënimit me burgim, nëse personi i tillë ka keqpërdorur këto funksione dhe është dënuar me burgim, si dhe zbatimin e aktvendimeve të gjykatës bazuar në Kodin Penal për ndalimin e zyrtarëve për të ushtruar funksione publike".

# KE-ja pranon se gabimisht kërkoi që shtetet e rajonit t'i vendosnin viza Kosovës

PRISHTINË, 6 DHJETOR - Komisioni Evropian pranoi se në raportin vjetor të monitorimit për shtetet që kanë liberalizim të vizave, të publikuar më 5 dhjetor, gabimisht ka vendosur një pasus ku Maqedonisë së Veriut dhe Malit të Zi u kërkohej që t'ia vendosnin regjimin e vizave Kosovës.

KE-ja tha se nuk ka asnjë ndryshim në qëndrimet e saj dhe mbështet fuqishëm liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës dhe kërkon që regjimi i vizave në zonën Schengen të hiqet pa vonesa për kosovarët.

Vendosja e pasusit ku kërkohej që Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi t'u vendosnin viza kosovarëve për shkak se, siç u pretendua, këto dy shtete nuk i kishin përshtatur politikat e vizave me Bashkimin Evropian, shkaktoi reagime në Kosovë, përfshirë edhe reagimin e ambasadorit të Kosovës në Bruksel, Agron Bajrami. Ai e cilësoi si "të papranueshëm" kërkesën për regjimin e vizave, por një ditë më pas tha se KE-ja do ta përmirësojë këtë gabim.



"Mund të konfirmoj se nuk ka absolutisht asnjë ndryshim në qëndrimet e Komisionit Evropian dhe ne absolutisht mbështesim lirinë e lëvizjes në rajon", tha në një konferencë për medie zëdhënësi i Komisionit Evropian, Eric Mamer.

KE-ja tha se ky gabim do të përmirësohet përmes një versioni të ri të po të njëjtit raport. Ky institucion i BE-së tha se nëse ky lëshim do të ishte i vërtetë, ai do të ishte në kundërshtim me mbështetjen e deklaruar të BE-së për lirinë e lëvizjes mes shteteve të rajonit të Ballkanit Perëndimor.

Presidentja e KE-së, Ursula von der Leyen, po ashtu ka mbështetur një marrëveshje të arritur në kuadër të Procesit të Berlinit për lëvizjen e lirë vetëm me letërnjoftime midis shteteve të Ballkanit Perëndimor.

Ndërkaq zëdhënësja për çështje të brendshme e KE-së, Anitta Hipper, tha se KE-ja "tërësisht mbështet lirinë e lëvizjes në rajon dhe tërësisht mbështet liberalizimin e vizave për Kosovën si çështje me prioritet". "Sa i përket çështjes specifike nga rajoni, jemi duke e përmirësuar dhe do të dalë versioni i përmirësuar", tha ajo.

Kosova është shteti i vetëm në rajon që nuk ka liberalizim të vizave me Bashkimin Evropian. Këshillit Evropian i është dhënë mandati që ta negociojë procesin e vizave për Kosovën me Parlamentin Evropian. Sipas vendimit, lëvizja pa viza për qytetarët e Kosovës do të jetë e mundur kur të hyjë në fuqi sistemi evropian i udhëtimit, ETIAS, dhe data për këtë është 1 nëntori i vitit 2023. Ky sistem kërkon që qytetarët e huaj, të cilët udhëtojnë pa viza në territorin e BE-së, t'i regjistrojnë të dhënat e tyre në këtë sistem para udhëtimit.

Franca ka qenë shteti që ka këmbëngulur më së shumti që hyrja në fuqi e liberalizimit të vizave për Kosovën të lidhet me funksionalizimin e ETIAS-it, duke thënë se ai është i rëndësishëm për rritjen e sigurisë së vendeve anëtare.

Liberalizimi i vizave do t'u mundësojë qytetarëve të Kosovës të udhëtojnë lirshëm në atë që njihet si zona Schengen, e që përbëhet prej 26 shtetesh evropiane. Por, në rast se do të ketë vonesa për këtë sistem, liberalizimi i vizave për Kosovën do të hyjë në fuqi jo më vonë se më 1 janar të vitit 2024. KE-ja ka konfirmuar qysh në vitin 2018 se Kosova i ka përmbushur të gjitha kushtet për liberalizimin e vizave, por kanë qenë disa vende anëtare që vazhdimisht kanë shprehur rezerva.

# Kërkohen zgjidhje konkrete për tërheqjen e investimeve

**Prishtinë, 6 dhjetor** - Rritja e mëtejme e bashkëpunimit për zhvillimin ekonomik në vend ishte tema e takimit të kryeministrit Albin Kurti me Këshillin Evropian të Investitorëve (European Investors Council).

Reformat e ndërmarra nga Qeveria e Republikës së Kosovës për përmirësimin e mjedisit të investimeve dhe të të bërit biznes në Kosovë, si dhe për rritjen e punësimit, u theksuan nga kryeministri Kurti.

Ai ka theksuar se World Justice Project e ka renditur Republikën e Kosovës në vendin e parë në Ballkanin Perëndimor për nga sundimi i ligjit dhe në vendin e dytë në botë për përmirësimin më të madh në sundimin e ligjit.

Duke theksuar rritjen e pashembullt ekonomike të Kosovës (10.7 për qind), e cila është më e larta në rajon dhe më e madhja që nga paslufta e Kosovës, si dhe rritjen e GDP-së, kryeministri i falënderoi investitorët për kontributin e dhënë në këtë rritje.

Në këtë bashkëbisedim u veçuan reformat legjislative si dhe zgjidhjet konkrete për tërheqjen e investimeve. Në takimin e përbashkët me drejtorin ekzekutiv të Këshillit Evropian të Investitorëve (EIC), Emrush Ujkani dhe përfaqësues të EIC, u theksua se dialogu i hapur, konstruktiv dhe i qëndrueshëm ndërmjet institucioneve dhe investitorëve, do të kontribuojë në përmirësimin e mjedisit të investimeve në Kosovë dhe rritjen e investimeve të huaja direkte.



# Të premten Ligji i Pagave shqyrtohet në Kuvend



**Prishtinë, 6 dhjetor** - Të enjten, më 8 dhjetor, në orën 12:00, Kuvendi i Kosovës do të mblidhet në seancë plenare, për t'i shqyrtuar pikat e papërfunduara nga seancat e kaluara plenare. Ndërkaq, të premten, më 9 dhjetor, në orën 10:00, do të mbahet seancë e re. Kështu vendosi Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e së martës, të drejtuar nga kryetari Glauk Konjufca, në të cilën morën pjesë edhe kryetarët e grupeve parlamentare.

Në seancën e së premtes, pas deklarimeve jashtë rendit të ditës dhe pyetjeve parlamentare, Kuvendi pritet të shqyrtojë një sërë projektligjesh dhe raportesh si dhe të zgjedhë disa anëtarë të bordeve dhe drejtuesish të disa institucioneve të pavarura.

Shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, ka bërë me dije se në rend dite në këtë seancë do të jetë Ligji i Pagave.

Po ashtu, Kuvendi pritet të mblidhet në seancë të jashtëzakonshme të enjten, më 8 nëntor, në orën 11:00, për ta shqyrtuar vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr. 01/110, datë 29.11.2022, për zgjatjen e masave emergjente për furnizimin e energjisë edhe për 30 ditë.

## Hoti thotë se ka menaxhim katastrofal të parasë publike

**Prishtinë, 6 dhjetor** - Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, ka thënë se Agjencia e Statistikave vlerëson se në tremujorin e tretë të vitit 2022, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, çmimet e prodhimit për biznese u rritën 17.2 për qind mesatarisht. Sipas Hotit, rritjen më të madhe e kanë pasur energjia elektrike dhe gazi me 49.7 për qind, duke i rritur kështu çmimet e produkteve të konsumit të përditshëm. "Sikur të ulej TVSh-ja dhe të hiqej akciza përkohësisht, siç kemi propozuar në pranverë, sot çmimet e prodhimit për biznese do të ishin më të ulëta. Rrjedhimisht, çmimet e produkteve të konsumit të përditshëm do të ishin më të ulëta dhe jeta e familjeve do të ishte më e lehtë", ka shkruar Hoti në "Facebook".

Hoti thotë se sikur të ulej TVSh-ja dhe të hiqej akciza, sot nuk do të kishim 700 milionë euro në llogari të qeverisë, të cilat po i zhvlerëson inflacioni. "Rreth 300 milionë euro do të ishin në buxhetin e familjeve dhe bizneseve dhe do të qarkullonin në ekonomi. As nuk i shpenzojnë mjetet për projekte kapitale dhe për rritje të pagave, as nuk ua lënë qytetarëve t'i shpenzojnë. I mbledhin pa nevojë, i mbajnë në llogari dhe zhvlerësohen nga inflacioni. Çfarë menaxhimi katastrofal i parasë publike", ka theksuar kryeministri Hoti.



# Bazat dhe përgatitja e luftëtarëve të UÇK-së në Shqipëri

Prof. asoc. dr. Bernard ZOTAJ




Në kuadrin e përgatitjes dhe zhvillimit të luftës së Kosovës, pas përmbysjes së sistemit në ish-Jugosllavi, populli shqiptar dhe kosovar shfaqën dhe afirmuan mjaft përvoja dhe dukuri të reja si dhe konfirmuan angazhim për ndihmesë, organizim dhe përgatitje të luftëtarëve të lirisë.

Shpërthimi i luftës në Jugosllavi nuk ishte i paparashikuar nga politika zyrtare e Shqipërisë moniste. Por shpërbërja dhe lufta në Jugosllavi ndodhën njëkohësisht me rënien e sistemit socialist në Shqipëri.

Rënia e sistemit në Shqipëri u shoqërua me tronditje e dëme të mëdha: me djegie e shkatërrime barbare dhe eksode masive. Fuqia e shtetit shqiptar po shteronte, rinia që përbënte forcën e ushtrisë po braktiste atdheun. Kështu, në kohën kur ne duhej të ishim më të fuqishëm se kurrë për t'i dhënë Kosovës ndihmë konkrete maksimale, u gjendem më të dobët se kurrë.

Presidenti shqiptar i atëhershëm, Ramiz Alia, me sa duket kishte arritur në përfundim se Kosova duhej ndihmuar me çdo kusht, sepse kishte ardhur momenti më i volitshëm dhe i papërsëritshëm, që edhe ajo të ngrihej e të kërkonte të drejtat e veta, njëlloj si kombet e tjerë të Jugosllavisë. Në cilësinë e kryetarit të Shtetit, në një fjalim që mbajti në OKB në shtator 1990, paralajmëroi Bashkësinë Ndërkombëtare për padrejtësitë që i ishin bërë kombit shqiptar, duke shtruar problemin e rishikimit të këtyre padrejtësive historike. Ai paralajmëroi se shqiptarët e Kosovës "nuk kërkojnë asnjë të drejtë më shumë nga ç'kërkojnë serbët, sllovenët, kroatët, apo maqedonasit. Ata nuk kanë pranuar e nuk do të pranojnë të kenë më pak të drejta se ata".[1]

Ndërsa në vitin 1991, në funksionin e komandantit të përgjithshëm, mori mbi vete përgjegjësinë dhe urdhëroi dikasterin përkatës, që të ndihmoheshin djemtë e Kosovës me gjithçka të mundshme për t'u stërvitur ushtarakisht e për t'u armatosur me qëllim që ta fillonin luftën çlirimtare në Kosovë në një kohë me republikat e tjera veriore të Jugosllavisë.

Dy grupet themeluese të luftëtarëve të UÇK-së në Shqipëri erdhën nga tremujori i katërt i vitit 1991. Grupi i parë ishte grupi i Zahir Pajazitit, i cili u përgatit në Elbasan dhe përbëhej nga rreth 54 veta. Ndërsa grupi i dytë kryesohej nga Adem Jashari dhe u përgatit në Tiranë, përkatësisht në Surrel, në malin e Dajtit. Grupi i Adem Jasharit përbëhej nga 34 veta. Të dy këta grupe u përgatitën rreth një muaj secili, përkatësisht në tetor dhe dhjetor të vitit 1991.[2]

Grupi i Adem Jasharit është përgatitur dhe stërvitur nga ushtarakët shqiptarë Hysen Ymeri, Agron Dhimarko, Ylli Mici dhe Kastriot Hoxha, i cili ishte dhe komandant i repartit. Këta përgatitën në mënyrë të organizuar prej shtetit shqiptar djemtë e parë të Kosovës, nga pikëpamja ushtarake. Oficerët e ngarkuar e mirëpritën detyrën. E konsideruan dhe e vlerësuan si një nder të madh, që u bëhej duke u besuar të stërvitin kontingjentet e para që do ta nisnin luftën çlirimtare në Kosovën e pushtuar nga Serbia. Këta e kryen me nder misionin, nuk ndien lodhje, duke zhvilluar stërvitje nga 16 orë në ditë.[3]

Trajnimi i këtyre grupeve konsistonte në përgatitjen e zjarrit, në përgatitjen fizike, në elementë të luftës guerile dhe elementë të tjerë të luftimit në terrenit etj. Secili inspektor ushtarak shqiptar jepte lëndën e tij ushtarake. Serioziteti i tyre në përgatitje zjarri e në qitje ishte shumë i madh. Këta ushtarakë shqiptarë ua mësuan të gjitha armët e lehta të këmbësorisë që nga pistoleta, pushka, automatiku, mitralozi i lehtë dhe i rëndë, granatahedhësi dhe mortaja 60 mm dhe 120 mm. Grupet gjithë ditën bënim qitje me armët e zjarrit. Ata zhvillonin dhe qitje kolektive si nga pozicione zjarri taktike, me të gjitha llojet e armëve dhe me granata. Instruktorët shqiptarë kishin si qëllim t'i çlironim nga emocionet e luftës, t'i mësonim me krismat e luftës, por dhe me disiplinën e zjarrit kolektiv.

Në vitin 1993, duke qenë ilegal, Adem Jashari vjen përsëri në Shqipëri për ta takuar vëllanë e tij, Rifatin, që vinte nga Gjermania. Ndërkohë, mori pjesë dhe në ceremoninë e diplomimit të anëtarit të celulave të UÇK-së, Kadri Veselit, që studionte në Tiranë. Megjithëse e kishin të ndaluar të lëviznin në vende të pakontrolluara, Adem Jashari dhe shokët e tij, gjatë kohës që përgatiteshin në Tiranë, zhvillonin dhe një aktivitet të gjerë në interes të objektivit për të cilin përgatiteshin. Ademi Jashari edhe kohë më parë kishte kontakte me njerëz që vinin ilegalisht nga Perëndimi për probleme të çështjes kosovare. Takimet bëheshin në Tiranë dhe në Durrës. Në Durrës bazën e kishin në shtëpinë e Ramë Sylmetës, nga Kërçina e Gjakovës, dhe që ishte me banim në Zvicër. Kjo shtëpi u kthye në një bazë të rëndësishme UÇK-së si para ashtu dhe gjatë luftës në Kosovë.

Kryesisht nga viti 1993 e në vazhdim, aktiviteti i aktivistëve (luftëtarëve) kosovarë erdhi në rritje në Shqipëri. Në këtë kohë sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Manfred Vërneri, gjatë një vizite që bëri në Shqipëri në vitin 1993, më19 mars, mbajti një fjalim para Kuvendit të Shqipërisë ku, mes të tjerash, tha: "Ministrat e jashtëm të NATO-s kanë deklaruar se një shpërthim i dhunës në Kosovë, që mund të ndodhë nga përhapja e konfliktit, do të përbëjë një kërcënim për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare". "Përhapja e konfliktit në Kosovë… do të kishte konsekuenca të tmerrshme". "Aleanca jonë do t'i mbështesë përpjekjet ndërkombëtare për të parandaluar që të mos ndodhë kjo dhe që të gjithë ne, në Aleancë, mbështetemi shumë te Shqipëria…".[4]

Një urdhër i tillë nuk pritej nga Verneri, që shqiptarët e konsideronin mik dhe e respektuan me të gjitha nderimet dhe komplimentet. Natyrisht, ai foli në emër të Evropës, si udhëheqësi politik kryesor i NATO-s. Ky urdhër theksonte hapur që të mos përkrahej Shqipëria dhe asnjë formë qëndrese e armatosur e shqiptarëve të Kosovës kundër dhunës dhe gjenocidit serb, asnjë formë qëndrese e shqiptarëve të Kosovës për liri sepse, sipas tij, kjo do të kishte "konsekuenca të tmerrshme". Dhe Qeveria Shqiptare, që kërkonte të anëtarësohej në Aleancë, nuk kishte si të mos zbatonte urdhrat e tij.

Megjithëse ndihma e shtetit shqiptar u bllokua, luftëtarët e Kosovës të cilët ishin të përkushtuar në çështjen e lirisë, gjetën mbështetje në Shqipëri te patriotët e vërtetë, krijuan baza të sigurta, qendra ilegale stërvitjeje dhe bënë furnizimin me armë. Shpirti patriotik shqiptar u ngrit mbi politikën. Shqipëria, edhe pa dëshirën e shtetit të vet, mbeti bazë kryesore e UÇK-së dhe e luftës së Kosovës.

Adem Shehu nga Farka e Tiranës, oficer kundërajror i Ushtrisë Shqiptare, diplomuar në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve në Tiranë, në vitin 1980, shërbyer në reparte e njësi të Mbrojtjes Kundërajrore të Kryeqytetit, do të bëhej një nga komandantët më në zë të UÇK-së. Në vitin 1996 u lidh me ilegalët e Lëvizjes Kombëtare për Çlirimin e Kosovës, me Sejdi Veselin, Nazmi Zukën, Fatmir Humollin e të tjerë.

Në vendlindjen e tij, në Farkë, në periferi të qytetit të Tiranës, organizoi stërvitjen luftarake të luftëtarëve të cilët vinin nga Kosova, trojet etnike dhe nga vendet perëndimore për t'u stërvitur. Grupet përbëheshin nga 25-30 veta dhe Adem Shehu i stërviste ata ilegalisht. Banesa e tij u shndërrua në një qendër stërvitore, pra në një "Akademi" të Farkës. Stërvitja e çdo grupi vazhdonte rreth tri javë. Në stërvitje zhvillohej njohje armatimi, përgatitje zjarri dhe veprime të thjeshta taktike. Stërvitja përfundonte me qitje reale. Pas përfundimit të stërvitjes së grupit vinte grupi tjetër.[5]

Pas marsit 1998, kur UÇK-ja kaloi në veprime luftarake në shkallë të gjerë, Adem Shehu mbante lidhje të vazhdueshme me luftëtarët që kishte përgatitur vetë. Atyre u kërkonte t'i sillnin skicat e veprimeve luftarake dhe aktin e rënies së luftëtarëve në ndeshje me armikun. E shqetësonte së tepërmi rënia e luftëtarëve, të cilët ishte përpjekur t'i mësonte se si ta vrisnin armikun e të mos vriteshin prej tij. Duke analizuar skemat e luftimit, ai arriti në përfundim për të pasqyruar në stërvitjet me grupet pasardhëse mangësitë e organizimit të luftimit në terrenin konkret.

Vendimi i Qeverisë Shqiptare me datë12 tetor 1998 për ta vënë në dispozicion të NATO-s të gjitha bazat ajrore e detare, si dhe gjithë hapësirën ajrore dhe rrjetin rrugor, ishte një vendim tepër i rëndësishëm historik. Ky vendim, i marrë për Kosovën, e shndërronte Shqipërinë në bazë ushtarake të NATO-s, për një sulm të mundshëm kundër Serbisë. Ky vendim tepër i guximshëm, që mori qeveria e kryeministrit të ri, Pandeli Majko, ishte një akt që e angazhonte Shqipërinë drejtpërdrejt në luftë me Serbinë, përkrah NATO-s. Lidhur me këtë vendim, komandanti suprem i NATO-s, gjenerali Uesli Klark, ka shkruar: "Kryeministri i ri, Pandeli Majko, me një anglishte perfekte, miratoi çdo kërkesë timen: – A mund të përdornim edhe aeroporte shtesë? – Natyrisht përdor të gjitha aeroportet. – A mund ta riparonim rrugën për në Kukës? -Të lutem, riparojeni. – Po rrugën për në Shkup? – I ke të gjitha rrugët dhe mjetet në dispozicion. Merrni çfarë të doni".[6]

Ushtria Shqiptare praktikisht u angazhua në luftë të pashpallur me Serbinë. Divizioni i Kukësit gjendejnë skalion të parë dhe në drejtimin kryesor të mbrojtjes së Shqipërisë. Ndërkohë, ky divizion u bë mbështetje e sigurt e shpinës së luftëtarëve të UÇK-së. Në territorin ku vepronte divizioni, UÇK-ja kishte bazat kryesore të saj. Fshatrat Padesh, Papaj, Gegaj, Kamenicë, Tropojë e Vjetër, Vlahen, Cahan etj., kanë qenë krejtësisht rajone veprimi e përqendrimi të UÇK-së. Ndërsa qendrat stërvitore në thellësi të zonës së mbrojtjes së Divizionit dhe në thellësinë strategjike të vendit u përdorën gjerësisht për përgatitje nga luftëtarët e UÇK-së. Prej territoreve tëdivizionit drejtoheshin për në Kosovë luftëtarët e UÇK-së, tashmë të stërvitur, të përgatitur dhe të armatosur prej Shqipërisë. Kishte dhe raste që sapo kalonin kufirin, binin në përpjekje me forcat serbe dhe zhvillonin luftime të ashpra, duke pasur të siguruar shpinën nga forcat e divizionit.

→



Në pranverën e vitit 1999 mjaft kuadro të ushtrisë shqiptare morën detyrë t'i përgatisnin luftëtarët e UÇK-së që vinin nga Perëndimi. Kuadrot dhe ushtarët shqiptarë e ndien përgjegjësinë dhe u mobilizuan për përgatitjen e kushteve për jetesë dhe stërvitjen e tyre, kur erdhën dhe luftëtarë të "Atlantikut" nga ShBA-ja, por dhe prej vendeve perëndimore si Kanada, Franca, Gjermani,Zvicrae kudo. Mosha e luftëtarëve varionte nga 15-74 vjeç.[7]

Luftëtarët e lirisë kishinnjë respekt shumë të madh për eprorët e tyre. Kur vinin eprorët në qendrën stërvitore vazhdimisht ishin të shoqëruar me roje, si në luftë. I ruanin djemtë e UÇK-së eprorët e tyre me një besnikëri vetëmohuese. Organizimin e kishin të përsosur dhe konspirativ, kërkonin rregull e disiplinë, ishin me kulturë dhe edukatë, edhe në mes të pyllit kërkonin koshin e mbeturinave për të hedhur bishtin e cigares. Por, mbi të gjitha, gjënë më të shtrenjte në botë kishin Flamurin.

Luftëtarët e batalionit të "Atlantikut" kishin një vullnet të jashtëzakonshëm për të mësuar për luftën dhe dinamikën e saj. Pasioni më i madh i tyre ishte arma. Gjatë mësimit teorik dhe stërvitjes në terren, si dhe në çdo veprim kishin frymën e kritikës. Batalioni "Atlantiku" u stërvit në Mollas të Burrelit. Për stërvitjen e Batalionit "Atlantik" angazhuan ushtarakët më të përgatitur dhe atdhetarë të përkushtuar. Stërvitja zhvillohej në kazermat dhe poligonet e njësisë së Burrelit, në një terren mjaft të përshtatshëm.

Qyteza e Mollzave[8] dhe poligonet përreth saj, në prill-majin e vitit 1999 ishin mbuluar nga gjelbërimi natyror dhe nga uniformat e kamuflazhit të një ushtrie të madhe. Në Mollza ishin përqendruar forca të shumta luftëtare, çka i habiti gjeneralët dhe atashetë ushtarakë të vendeve të NATO-s, kur bënë një inspektim në terren.

Luftëtarët ishin prej të gjitha moshave, por dominonte mosha e re, 18-25-vjeçare, djem dhe vajza. Ishin të gjithë të shëndetshëm, me trupa të hedhur, elegantë, me fytyra të bukura, që ishin rritur midis të gjitha të mirave në vendet perëndimore, që armët i kishin parë vetëm nëpër filma, tani kishin ardhur në Mollza, në këtë vend të fshehtë, për t'u përgatitur për luftë. Ishin mbi 40 oficerë shqiptarë shumë të aftë që u ishte ngarkuar të zhvillonin stërvitje me luftëtarët e rinj të "Atlantikut", por dhe kosovarë të ardhur nga Evropa e Kosova.

Oficerët shqiptarë e kishin kuptuar detyrën e tyre. Ata hartuan një program stërvitor tepër të ngjeshur. Për një muaj duhej t'u mësonin luftëtarëve që nuk kishin prekur ndonjëherë pushkë me dorë, të gjitha llojet e armëve të këmbësorisë, si dhe të zhvillonin qitje luftarake. Do t'u mësonin veprimet e ushtarit në fushën e luftimit. Të gjitha këto, ushtari i kohës së paqes, i mëson gjatë një viti stërvitor. Ndjenja e përgjegjësisë së këtyre oficerëve do të shtohej gjithnjë e më tepër, në procesin e zhvillimit të stërvitjes, kur shikonin etjen e atyre të rinjve për të mësuar gjithçka në një ditë. Por edhe më tepër shpirtin e këtyre oficerëve të talentuar, që ishin të zgjedhur me "kokrra", e prekte fakti se djemtë dhe vajzat që po stërvitnin, do t'i nisnin për luftë. Këta nuk duhej të vriteshin kot. Këta duhej ta vrisnin armikun e të mos vriteshin prej tij. Këtu qëndronte thelbi i misionit të tyre të lartë. Prandaj oficerët e Shqipërisë Mëmë u kërkonin shumë në stërvitje. Nuk lejonin asnjë gabim në përdorimin e armëve. Nuk falnin asnjë gabim gjatë lëvizjeve në fushën e stërvitjes, që e konsideronin si fushë luftimi. Ata jepnin shembullin personal në çdo veprim, duke mos treguar lodhje në asnjë moment.[9]

Disiplina e lartë në stërvitje, gatishmëria dhe mobilizimi i jashtëzakonshëm i vullnetarëve të lirisë për ta zbatuar pa hezitimin më të vogël çdo mësim, çdo sugjerim e korrigjim të oficerëve, ishte një shembull tepër i rrallë. Në marrëdhëniet me ushtarakët shqiptarë luftëtarët kishin shuar çdo ndjenjë kundërshtimi. Fjala e tyre ishte ligj. Disiplina e lartë, e ndërgjegjshme, bëri që të zhvilloheshin të gjitha stërvitjet, të gjitha qitjet (3-4) me pushkë, me automatikë, me mitraloz të lehtë e të rëndë, me mitraloz kundërajror 12,7 milimetër, me granatahedhës e me mortajë në mënyrë shembullore. Zhvillonin qitje me rreth dy mijë veta në ditë dhe asnjë incident nuk ndodhi në saje të zbatimit të përpiktë të rregullave të sigurimit teknik.

Djemtë e vajzat e Kosovës të ardhur nga Perëndimi si luftëtarë të UÇK-së jo vetëm morën mësimet e nevojshme për luftë, por dhe lanë tek ushtarakët shqiptarë mirësjellje dhe, veçanërisht disiplinë pune, disiplinë mësimi dhe disiplinë lufte. Shumica e luftëtarëve ishin studentë që kishin ndërprerë studimet dhe me vetëdije të lartë atdhetare e kombëtare kishin ardhur të mësonin e të futeshin në luftë për ta çliruar Kosovën. Ata nuk mendonin fare se çdo të thotë të vritesh, të vdesësh pasi atë e kishin për krenari, sikur shkonin në dasmë. Atyre u mësonim edhe mortajën 82 mm. Ishin tepër kureshtarë dhe kërkonin të mësonin me hollësi çdo detaj. Kishte dhe luftëtarë që kishin kryer shërbimin ushtarak në ushtrinë jugosllave dhe tregonte se serbi nuk ua mësonte armët shqiptarëve, por i ngarkonte me punë të rëndomta.

Në qendrën stërvitore të UÇK-së në Mollas të Burrelit u trajnuan për një muaj e ca nga 1 800-2500 luftëtarë.[10] Ushtarakët shqiptarë hartuan një program stërvitor njëmujor të ngjeshur me elementët më të domosdoshëm për t'u përgatitur për luftë. Ai përmbante edhe zhvillimin e dy qitjeve duke pasur parasysh që mbi 90% e luftëtarëve nuk kishin parë armë me sy.[11] Ushtarakët shqiptarë çdo mëngjes herët merrnin togat e tyre dhe fillonin stërvitjen e cila zgjaste gjatë gjithë ditës. Luftëtarët kishin një nderim të veçantë për oficerët shqiptarë.

Qyteza e Mollzave çdo mëngjes zgjohej me Himnin Kombëtar të Flamurit. Të gjitha forcat rreshtoheshin në sheshin e nisjes për stërvitje. Të gjithë luftëtarët dilnin në rreshtimin ceremonial të ngritjes së Flamurit. Flamuri ngrihej me komandë dhe të gjithë qëndronin gatitu, si të ngrirë. Himnin e Flamurit e këndonte një togë. Populli i Burrelit u mahnit me disiplinën e kësaj ushtrie dhe me shenjtërinë që ajo tregonte për Flamurin, kryesimbolin e kombit.

Repartet e UÇK-së, në Mollza të Burrelit, por ai i Fekenit, treguan se ishin pjesë e një ushtrie të rregullt, e një ushtrie me ideale të shenjta çlirimtare dhe kombëtare. Ato ishin pjesë e një ushtrie me simbole, me flamurin e vet kombëtar.

## Përfundim

Shqipëria në vitet '90të shek. XX u përballua me rënien e sistemit socialist, por vëmendja e saj ishte se Kosova duhej ndihmuar me çdo kusht. Kishte ardhur momenti më i volitshëm dhe i papërsëritshëm, që edhe ajo të ngrihej e të kërkonte të drejtat e veta, njëlloj si kombet e tjerë. Djemtë e Kosovës duheshin ndihmuar me gjithçka të mundshme për t'u stërvitur ushtarakisht e për t'u armatosur me qëllim që ta fillonin luftën çlirimtare në Kosovë. Grupet themeluese të luftëtarëve të UÇK-së në Shqipëri kanë ardhur nga tremujori i katërt i vitit 1991. Ushtarakët shqiptarë u mësuan luftëtarëve të gjitha armët e lehta të këmbësorisë, bënë përgatitje për qitje me armët e zjarrit, si dhe zhvilluan përgatitje taktike.

Luftëtarët e Kosovës të cilët ishin të përkushtuar në çështjen e lirisë, gjetën mbështetje në Shqipëri te patriotët e vërtetë, krijuan baza të sigurta, qendra ilegale stërvitjeje dhe bënë furnizimin me armë. Shpirti patriotik shqiptar u ngrit mbi politikën. Shqipëria, edhe pa dëshirën e shtetit të vet, mbeti bazë kryesore e UÇK-së dhe e luftës së Kosovës.

Ushtria Shqiptare praktikisht u angazhua në luftë dhe Divizioni i Kukësit u gjend në skalion të parë dhe në drejtimin kryesor të mbrojtjes shqiptare. Ky divizion u bë mbështetje e sigurt e shpinës së luftëtarëve të UÇK-së dhe në territorin ku vepronte divizioni, UÇK-ja kishte bazat kryesore të saj. Djemtë e vajzat e Kosovës të ardhur nga Perëndimi si luftëtarë të UÇK-së jo vetëm morën mësimet e nevojshme për luftë, por dhe lanë tek ushtarakët shqiptarë mirësjellje, veçanërisht disiplinë pune, disiplinë mësimi dhe disiplinë lufte.

---

[1] Gazeta Zëri i Popullit, 30 shtator 1990, f. 4.

[2] Sokol Poga, intervistë dhënë gazetës Dita, 27 mars 2013, f. 2-3.

[3] Husen Ymeri, …Stërvitëm edhe Adem Jasharin, Tiranë, 2009, f. 245.

[4]NATO – Organizata e Traktatit të Atlantikut, Shtëpia Botuese e Ushtrisë, Tiranë 1994, f. 327.

[5]Halil Katana, Tri dimensionet e Luftës Çlirimtare të Kosovës, Tiranë, 2002, f. 197.

[6]U. Klark, Lufta ime në Kosovë, suplement i gazetës Korrieri, 24 qershor 2001, f. 10.

[7]Halil Katana, revista Mbrojtja, nr. 6. Tiranë, 2000, f. 49.

[8] AQFA, MM, Urdhër nr. 1950, datë 14.06.1999.

[9] AQFA, MM, Urdhër, nr. 2487, datë. 24.04.1999.

[10] Major Bernard Zotaj, material teorik, Mendime dhe probleme nga stërvitja në qendrën stërvitore Mollas-Burrel, korrik 1999, f. 6.

[11] Revista Mbrojta, nr. 11, Tiranë, 1999, f. 85.

*(Marrë nga libri "Ushtria Çlirimtare e Kosovës, vlerë kombëtare", botuar nga Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës. Kjo kumtesë është paraqitur në sesionin shkencor mbajtur në Prishtinë më 7 mars 2022, organizuar nga: Instituti Albanologjik i Prishtinës, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave e Shqipërisë dhe Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës. Kumtesat e njëzet intelektualëve shqiptarë gazeta "Epoka e re", përpos në portal, do t'i botojë për njëzet ditë me radhë edhe në formatin pdf. Librin mund ta gjeni në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës.)*

# Ndihmesa e ushtrisë shqiptare në organizimin dhe përgatitjen e UÇK-së



Prof. asoc. dr. Marenglen KASMI

Që nga fitorja e luftës së UÇK-së me mbështetjen e NATO-s kanë kaluar mbi 22 vjet dhe tashmë UÇK-ja dhe lufta e saj për çlirimin e Kosovës janë bërë pjesë e historisë më të lavdishme të popullit të saj, çka çoi në çlirimin e vendit dhe shpalljen e Pavarësisë.

Por, edhe UÇK-ja ka historinë e saj, fillimet e së cilës, organizimi dhe armatosja, stërvitja dhe përgatitja, ashtu si dhe liderët e organizatorët e saj të shquar, gjenden përpara në kohë. Në këtë histori, një pjesë jo pak të rëndësishme zënë padyshim edhe ata njerëz e vende që e mbështetën organizimin, furnizimin, disiplinimin, stërvitjen e përgatitjen luftarake të kësaj ushtrie të re.

Trajtimi i kësaj teme është shumë delikate dhe vështirësohet ende nga mungesa e burimeve arkivore, qoftë vendase apo të huaja. Nëse për vitet 1980-1990 dokumentet arkivore mundësojnë një skicim të mirë të problematikës së Kosovës dhe përpjekjeve të saj për t'u çliruar në këto vite, nuk mund të thuhet e njëjta gjë për vitet 1990-1999, sepse arkivat janë ende të kyçura për këtë periudhë.

Pavarësisht prej këtyre vështirësive, studimi i autorëve të huaj, si Jens Reuter, Peter Schubert, Agilof Keßelring, Fred Abrahams, por edhe i atyre shqiptarë, mundësojnë trajtimin e kësaj teme. Po ashtu, një dimension të rëndësishëm studimor përbëjnë edhe dëshmitë e oficerëve shqiptarë, të cilët u përfshinë drejtpërsëdrejti në stërvitjen e luftëtarëve kosovarë, si në vitet 1991-1993, ashtu edhe masivisht më pas, gjatë luftës së Kosovës 1997-1999.

***

Viti 1991 shënoi rënien e regjimit komunist në Shqipëri. Shumë shqiptarë ishin të mendimit se, si regjimi i Enver Hoxhës, ashtu edhe qeveria e pasardhësit të tij Ramiz Alia, nuk kishin bërë asgjë për bashkimin e të gjithë shqiptarëve.[1] Tradicionalist, vizioni i një bashkimi kombëtar shqiptar kishte qenë ajo çka elita shpirtërore dhe intelektuale shqiptare kishin artikuluar në vazhdimësi. Ishte pikërisht kjo elitë, e cila shpresonte që tashmë, me rënien e regjimit komunist, qeveria e parë demokratike shqiptare do të angazhohej fuqishëm për zgjidhjen e çështjes kombëtare. Sigurisht që edhe zhvillimet në Evropën Lindore dhe bashkimi i Gjermanisë zgjonte te kjo elite shpresën se zgjidhja e çështjes kombëtare ishte një hap më pranë realizimit. Fillimi i luftës civile në Jugosllavi, në verën e vitit 1991, shkaktoi jo pak shqetësime në Tiranë. Nga njëra anë, Tirana trembej në zgjerimin e një konflikti edhe në Kosovë, e rrjedhimisht edhe në Shqipëri dhe, nga ana tjetër, shpresonte se humbja e Serbisë në këtë konflikt do të ishte në favor të zgjidhjes së çështjes kombëtare. Ndonëse në fillimvitet 1980 ishte hartuar një plan me karakter mbrojtës përgjatë kufirit me ish-Jugosllavinë, ai kishte në të edhe elementë planëzues ofensivë për territorin e Kosovës. Për Tiranën e vitit 1991 ishte e qartë se një konflikt i armatosur me Jugosllavinë në këtë kohë ishte diçka shumë e rrezikshme.

Gjithsesi, ka burime të cilat tregojnë se në vitin 1991 Ramiz Alia pranoi që ushtria shqiptare ta fillojë stërvitjen e disa luftëtarëve kosovarë. Ndër të parët që do të stërvitej në kampet ushtarake të ushtrisë shqiptare të ngritura me urdhrin e Alisë ishte edhe Adem Jashari. Lidhur me këtë fakt, Fred Abrahams, në librin e tij "Shqipëria e re" ka shkruar për një bisedë që ka zhvilluar në vitin 1991 me ish-presidentin e Shqipërisë të asaj kohe, në një takim me Xhavit Halitin. Abrahamsi shkruan: "Alia mundësoi njëfarë stërvitjeje, më treguan se Haliti, ashtu edhe ministri i Mbrojtjes Teta, LPRK-ja dërgoi në Shqipëri njerëz, duke përfshirë një luftëtar trupmadh që e quanin Adem Jashari…".[2]

Ky autor shkruan se personi i parë që erdhi në Shqipëri ishte Xhavit Haliti, përfaqësues i Lëvizjes për Republikën e Kosovës (LPRK) dhe në korrikun e vitit 1991 u takua me presidentin e asaj kohe, Ramiz Alinë. Ai e takoi presidentin me qëllimin dhe mendimin rreth fillimit "të një lëvizje ushtarake për çështjen e Kosovës".[3] Presidenti shqiptar, që i njihte mirë grupet e ndryshme kosovare, besonte se Kosova mund të çlirohej vetëm me anë të forcës.[4] Për t'i mbajtur lidhjet, ai caktoi këshilltarin e tij ushtarak, gjeneral-majorin Adem Çopanin, i cili ishte ushtarak i lartë i karrierës me përvojë.

Por, në fillim, siç është shprehur edhe ish-ministri i Mbrojtjes i Shqipërisë i asaj kohe, pati vështirësi sepse atëherë erdhën shumë grupe që kërkonin ndihmë. Ministria e Mbrojtjes urdhëroi Shkollën e Bashkuar të Oficerëve që me katedrat e saj të taktikës, zjarrit, zbulimit, xhenios etj. të hartonte dhe zhvillonte një plan stërvitor për grupe stërvitore me shqiptarë të Kosovës. Lidhur me stërvitjen ushtarake të luftëtarëve kosovarë, një autor dhe dëshmitar i kësaj lufte, ka shkruar se përgatitjen ushtarake Adem Jashari e ka marrë në Shqipëri nga oficerë të njohur të Ushtrisë Shqiptare.[5] Siç theksuam, stërvitja e tyre u zhvillua nga pedagogët më të mirë të Shkollës së Bashkuar, kështu që ky është një vlerësim më se i drejtë. Për fat të keq, ende nuk kemi gjetur burime arkivore të plota, për të arritur në të dhëna më të plota për emrat, sasinë e grupeve dhe atë çka këto grupe përfaqësonin.

Sipas dëshmive të disa oficerëve të Shkollës së Bashkuar që trajnonin luftëtarët kosovarë, në vitin 1992, me largimin e Alisë dhe ardhjen e presidentit Berisha, stërvitja e luftëtarëve kosovarë u ndërpre. Vlerësuar sot në retrospektivë, ky veprim nuk përbën ndonjë çudi. Para se Berisha të zgjedhej president, deklaratat e tij në lidhje me Kosovën shkonin në drejtim të irredentizmit.

Ndryshe si kryetar shteti: "Tirana e vlerësonte ndjekjen e një politike irredentiste në Kosovë, që mund të përfundonte në një luftë, si një rrezik jetik. Në këtë kohë të gjithë donin të shmangnin me çdo kusht një konflikt në Kosovë. Me politikën e tij paqësore, Ibrahim Rugova ishte një aleat natyral i Tiranës. Duket sikur ai ofron garancitë që kosovarët nuk do të kalojnë në një kryengritje të dhunshme, çka mund ta dëmtojë edhe Shqipërinë", shkruan historiani gjerman Jens Reuter.[6]

Në këto vite bie në sy që qeveria →

shqiptare kërkonte me çdo kusht t'i shmangte konfliktet në Kosovë.

Mbyllja e kampeve stërvitore ishte një rrjedhim i politikës së ndjekur nga qeveria e asaj kohe duhet vlerësuar në dy plane, si në atë të vizionit politik për çështjen e Kosovës, ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Në planin e brendshëm ndërprerja e mbështetjes për UÇK-në erdhi si pasojë edhe e frikës dhe dyshimeve kundër grupeve "majtiste", ndërsa në planin ndërkombëtar,si pasojë e presionit të tyre. Qeveria e Tiranës nuk mund të dilte kundër politikës së ndjekur nga Brukseli dhe Uashingtoni. Pa ndihmën financiare të Perëndimit ajo nuk do të mbijetonte.

**Në një situatë dhe kontekst krejt të ndryshëm ishte ndihma që UÇK-ja do të merrte në vitet 1997-1999.**

Nëse i referohemi historisë së krijimit të UÇK-së, sipas disa studiuesve të saj, fillimet e saj janë të kahershme. Fillesat apo zanafilla e saj duhen kërkuar që në kohën e Lëvizjes Politike, ilegale të pas Luftës së Dytë Botërore, e cila kulmoi me demonstratat e vitit 1981 në Kosovë. Atëkohë kërkesa themelore e demonstratave ishte "Kosova Republikë"! Sipas të dhënave të njohura të kohës, këta demonstrues, kudo që ndodheshin, në harkun kohor 1981-1990, nuk reshtën së kërkuari përmbushjen e çështjes së tyre, në rrjedhën e të cilave u krijuan organizatat e ndryshme politike. E përbashkëta e këtyre organizatave, në programet e tyre, qëndronte kërkesa për luftën e armatosur çlirimtare. Ndërkohë, veprimtarët e këtyre organizatave do të ishin ata që do ta përbënin bërthamën e saj, që do të lindte së shpejti për konkretizimin dhe realizimin e luftës së armatosur çlirimtare.

Në vitin 1997-1998, ndonëse qeveria shqiptare e kohës i ruhej një reagimi të komunitetit ndërkombëtar, përfaqësuesit e UÇK-së u lidhën dhe u ndihmuan nga institucionet e Mbrojtjes, Sigurisë dhe Informimit Shqiptar. Nëpërmjet kësaj marrëdhënie, që doli se ishte e duhura dhe vendimtare, teksa konflikti po përhapej, UÇK-ja mori ndihmën e mundshme.[7]

Duke pasur parasysh gjendjen e vështirë që po kalonte Shqipëria, sidomos në zonën në Veri të vendit, stërvitja ushtarake dhe furnizimi me armë ishte më i mundshëm. Prej nëntorit 1998 qeveria shqiptare lejoi ardhjen në Shqipëri të shumë meshkujve kosovarë që vinin nga jashtë vendit për të marrë pjesë në luftën për çlirimin e Kosovës. Ata vinin nga shumë vende të Evropës, por edhe nga ShBA-ja.

Shqipëria luajti në këtë rast një rol të rëndësishëm në pritjen, organizimin dhe përgatitjen e forcave të tjera luftarake për UÇK-në, si dhe në mbështetjen e forcave që tanimë operonin në Kosovë.

Kjo ndihmë përfshinte disa tregues të rëndësishëm që ndikonin në organizimin, stërvitjen dhe përgatitjen luftarake të luftëtarëve dhe komandantëve të formacioneve luftarake të UÇK-së. Pavarësisht që deri në fillimin e bombardimeve të NATO-s mbi forcat ushtarako-policore, shteti dhe qeveria shqiptare dukeshin të tërhequra, në fakt, ishin institucionet e tyre të mbrojtjes, sigurisë dhe informacionit që do të ndihmonin sa më shumë dhe me të gjitha mundësitë e tyre, gjithsesi të kufizuara, për shkak të situatës që kaloi vendi në vitet 1997-1998.

Në luftën e Kosovës dhe në organizimin e veprimtarisë së UÇK-së kanë dhënë një ndihmesë të çmuar disa faktorë gjeografikë, etnikë, ushtarakë etj. Një ndër vendet që për shkak të pozicionit gjeografik, të origjinës së njëjtë kombëtare dhe të përvojës ushtarake në pikëpamje organizative dhe të trajnimit profesional, por edhe logjistik, ishte Shqipëria.

Shqipëria ishte fare pranë me Kosovën dhe kishte mundësi të mëdha komunikimi që, për shkak të porteve detare dhe aeroportit, mundësonte ardhjen e shumë emigrantëve kosovarë, të cilët donin t'i bashkoheshin UÇK-së në luftën e Kosovës. Aq më shumë rritej kjo mundësi nëse i shtohet këtij fakti edhe një argument tjetër, identiteti i njëjtë kombëtar shqiptar. Ndërsa nga ana e kufirit me Serbinë, Malin e Zi dhe Maqedoninë, hyrjet, veçanërisht, por edhe daljet ishin tejet të vështira, për të mos thënë në kufijtë e të pamundurës për lëvizjen e luftëtarëve dhe aq më pak të furnizimeve logjistike ushtarake të UÇK-së.

Në këtë mënyrë, rrethanat dhe argumentet e mësipërme ndikuan që një barrë e konsiderueshme e kësaj lufte të binte mbi Shqipërinë edhe për përgatitjen luftarake të emigranteve kosovarë që vinin nga vendet e Evropës dhe nga ShBA-ja për të luftuar në Kosovë. Mirëpo të gjitha lëvizjet dhe veprimtaritë e mësipërme, më shumë se kudo tjetër, ishin nën vëzhgimin e përhershëm të vendeve evropiane dhe të vëzhguesve amerikanë, por më së shumti nga spiunët dhe agjentët e policisë së fshehtë dhe kundërzbulimit serb edhe brenda në Shqipëri. Ky vëzhgim euro-amerikan qe veçanërisht i vazhdueshëm dhe i shoqëruar me këshillime të pandërprera kur u zhvillua lufta e Kosovës.

Por, qeveria shqiptare ndihmoi dhe mbështeti NATO-n kur ajo vendosi ta niste fushatën e bombardimeve kundër Serbisë në mbështetje të luftës se UÇK-së për çlirimin e Kosovës. Qeveria shqiptare vuri në dispozicion të NATO-s aerodromet prej nga niseshin avionët e saj për t'i goditur objektivat serbe.

Në fazën përmbledhëse apo kurorëzuese të luftës së Kosovës, numri i vullnetarëve kosovarë që vinin nga vendet evropiane dhe ShBA-ja me synimin për të marrë pjesë në këtë luftë, kryesisht përmes porteve detare dhe aeroportit të shtetit shqiptar, u shtua dukshëm. Për rrjedhojë, lindi nevoja e organizimit të tyre nëpër reparte dhe përgatitja ushtarake e tyre, për t'u nisur më pas drejt veriut të vendit, prej ku këto reparte e njësi marshonin ushtarakisht për në zonat e përcaktuara në Kosovë.

Për këtë arsye u pa e nevojshme që procesin e mësipërm këta vullnetarë ta kryenin në Shqipëri, dhe jo pa arsye, sepse duke u përgatitur në Shqipëri këta luftëtarë, do të hynin menjëherë në luftë në Kosovë. Kjo përbënte një përparësi të madhe për UÇK-në. Por, veçse kjo nuk ishte aspak e lehtë, për shkaqet që i theksuam më parë, të vëzhgimit të rreptë të vëzhguesve ndërkombëtarë si dhe të agjenturës serbe. Që në prill të vitit 1998 UÇK-ja dhe CIA amerikane, me ndihmesën e ShIK-ut shqiptar, kishin rënë në një mendje për tri pika thelbësore në veprimtarinë e UÇK-së: UÇK-ja të mos ushtronte dhunë jashtë Kosovës, të mos bashkëpunonte me forca terroriste dhe të mos kishte financime të paligjshme. Për rrjedhojë, UÇK-ja nuk u përfshi asnjëherë në listat e Departamentit të Shtetit për organizatat terroriste. Madje, siç shkruan Abrahams, "ka dëshmi që tregojnë për stërvitje të kryera nga ekspertët amerikanë dhe britanikë në kampet e UÇK-së në Shqipërinë e Veriut. Çka ishte më e rëndësishme për UÇK-në, ajo po forconte besimin".[8]

Qeveria shqiptare u vu në mbështetje, si të forcave të NATO-s edhe të UÇK-së me të gjitha mundësitë që pati, ndërkohë që publikisht s'e pranoi asnjëherë mbështetjen dhe ndihmesën e drejtpërdrejtë dhe konkrete. Qeveria Majko pranoi në portet detare dhe ajrore prurjet në përmasa të mëdha të mijëra vullnetarëve kosovarë, që arrinin në Shqipëri nga disa vende të Evropës perëndimore dhe ShBA-ja, me qëllimin e vetëm për të luftuar në radhët e UÇK-së.

Por shumica e këtyre vullnetarëve →





nuk kishin njohuri për organizimin ushtarak dhe aq më pak për taktikën e luftës dhe përdorimin e armëve në luftime. Ata nuk njihnin jetën, disiplinën, uniformat, rreshtimin, urdhrat e eprorëve dhe bindjen për zbatimin e tyre. Pra ata nuk e njihnin as betimin ushtarak për sakrifica, përkushtimin deri në rënie për lirinë e popullit dhe atdheut.

Të ardhurit ishin të moshave nga 15 vjeç deri në 55 vjeç, por dominonin moshat 25-35-vjeçare, që zinte 75% të vullnetarëve kosovarë. Prej rreth 1800 vullnetarëve që pas gjashtë ditësh arritën në 2 500 veta, meshkuj dhe femra, rreth 40% e tyre e kishin kryer shërbimin ushtarak më parë në ushtrinë e ish-Jugosllavisë. Kjo përvojë reflektohej qartë në qëndrimin e tyre rreshtor, në pamjen e jashtme, mënyrën si reagonin dhe zbatonin urdhrat, sidomos në përdorimin e armëve, stërvitjen e përgatitjen ushtarake dhe qitjet me rezultate të larta.

Pjesa tjetër, më e madhe e vullnetarëve, kishin mangësi dhe vështirësi të dukshme në pamjen e jashtme, në mbajtjen e uniformës, në qëndrimin rreshtor, në përgatitjen ushtarake taktike, mosnjohjen dhe përdorimin e armëve dhe veçanërisht në qitje.

Për rrjedhojë, sipas të dhënave që vijnë nga disa burime, në territorin e Shqipërisë u ngritën dy qendra kryesore, pikërisht për organizimin dhe përgatitjen e forcave vullnetare. Të dhënat për qendrat stërvitore të mësipërme i pohon në një libër edhe një autor shqiptar, Halil Katana.[9] Por, sigurisht, që për këto baza është ruajtur fshehtësia për shkaqe të kuptueshme. Veçanërisht deri në fillimin e bombardimeve të NATO-s ngritja e qendrave ishte bazuar në urdhrat e ministrit të Mbrojtjes të Shqipërisë. Por, ndoshta është vendi për të folur shkurtimisht për veprimtarinë që kryhej në këto qendra, me detyrat dhe rregullin e funksionimit të tyre. Ato kishin për qëllim kryesor që, pas ardhjes në to në fshehtësi të vullnetarëve kosovarë, të merreshin me organizimin e tyre nëpër nënreparte, reparte e njësi ushtarake.

Si rregull, në këto qendra vullnetarëve kosovarë u jepeshin, brenda një periudhe prej disa javore (20-25 ditë), një varg njohurish ushtarake që nga ana formularë deri tek ato speciale – profesionale. Njohuritë nisnin me nderimin për Flamurin dhe Himnin Kombëtar, qëndrimin rreshtor, nderimin, urdhrat ushtarakë dhe rëndësinë e zbatimit të tyre, mbi disiplinën dhe moralin në luftë. Ndërkohë atyre u jepeshin mësime teorike dhe sidomos praktike për njohjen dhe përdorimin e taktikave të luftës, në mbrojtje, mësymje (sulm), në veprimtarinë e nënreparteve, po ashtu si dhe për bashkëpunimin dhe mënyrat e ndërlidhjes. Madje në këto qendra atyre iu dhanë njohuri xheniere për minat dhe ndërtimin e pozicioneve të mbrojtjes, deri edhe për mbrojtjen nga lëndët kimike që mund t'i përdornin forcat ushtarako-policore serbe gjatë luftimeve.

Por, rëndësi në to i jepej edhe përgatitjes fizike, si dhe mënyrës së kryerjes së marshimeve luftarake me nënrepartet dhe repartet e tyre përkatëse. Pas betimit ushtarak, repartet dhe njësitë e përgatitura niseshin drejt Veriut të Shqipërisë, siç shkruan Abrahams, "për stërvitje dhe mandej në front".[10]

Në prill të vitit 1999, në njërën prej qendrave stërvitore të Ushtrisë në Shqipëri, mbërritën nga ShBA-ja disa qindra vullnetarë që më pas u organizuan në atë që më vonë u emërtua Batalioni "Atlantiku". Shumica e tyre nuk kishin qenë në shërbim ushtarak dhe nuk kishin njohuri për disiplinën ushtarake, për armët etj. Ata kishin sidomos mangësi në njohjen e taktikave të luftës.

Sipas të dhënave dokumentare të kohës, për të organizuar dhe përgatitur si luftëtarë vullnetarët nga ShBA-ja, që fillimisht kapnin shifrën 1800 veta, por vetëm pas gjashtë ditëve arritën në 2 500 veta, ishte përzgjedhur një grup oficerësh, mësimdhënës metodikë dhe me përvojë. Për tre-katër javë grupi i madh i vullnetarëve u organizua mbi bazën e batalioneve, kompanive, togave dhe skuadrave, me komandantët e tyre në krye. Ato u organizuan sipas modelit të ushtrive të kohës. Komandantët e nënreparteve në rastin më të mirë ishin ish-oficerë të ushtrisë jugosllave ose vinin nga radhët e atyre që kishin kryer shërbimin ushtarak. Për t'i arritur synimet e përgatitjes ushtarake dhe luftarake të vullnetarëve ishte përgatitur një program. Në të ishin përfshirë tema mbi stërvitjen rreshtore, përgatitje zjarri për t'i njohur armët në përdorim, taktikë për disa lloje luftimesh, njohuri për disa specialitete kryesore si xhenio, ndërlidhje dhe mbrojtje kundërkimike, si dhe qitje pothuajse me të gjitha armët që përdorte UÇK-ja. Është e kuptueshme që pjesën kryesore të programit e zinin njohuritë teorike dhe sidomos stërvitjet taktike praktike si dhe mësimet për njohjen e armëve personale dhe kolektive, të cilat kulmonin me qitje në terren. Të gjithë vullnetarët zhvilluan qitje me automatikë, mitraloza, topa kundërtank, granatahedhës të lehtë, madje edhe me granata dore.

Mësimet dhe stërvitja praktike taktike për luftimet mbrojtëse, pozicionale dhe sulmuese apo në prita mësohej sipas artit ushtarak bashkëkohor dhe jo sipas luftimit tradicional që ata njihnin nga të parët apo që kishin lexuar. Për t'iu afruar dhe përshtatur sa më shumë terrenit në Kosovë, stërvitjet u zhvilluan në terrene fushore, kodrinore dhe në terrene të thyera e malore. Nga ana tjetër vëmendje e veçantë iu kushtua stërvitjeve me efektivë, për një forcë si ajo e UÇK-së që luftonte në terrenin e saj që e njihte më mirë se forcat serbe.

Stërvitjet e kryera edhe në kushte të rënda të motit me shira dhe baltë duke u gërshetuar me lëvizjet dhe marshimet e shpejta e të përhershme si dhe maskimet sipas terrenit konkret. Programi ishte konceptuar mbi bazën e orëve mësimore me nga 50 minuta secila, kurse një ditë stërvitore zgjaste deri në tetë orë. Ndërsa stërvitjet e natës fillonin pas rënies së errësirës dhe zgjasnin deri afër mesnatës. Në program ishte parashikuar edhe stërvitja për mbijetesën e efektivave në përgatitje si ushqimi i thatë, fjetja në fjetore të përbashkëta me qindra veta dhe në kushte të vështira në natyrë etj.

Duhet theksuar se shumica e vullnetarëve vinin nga jeta civile, nga emigracioni. Fillimisht ata patën vështirësi, por shpejt i tejkaluan ato dhe i përvetësuan njohuritë e nevojshme për luftë. Më me vështirësi u përvetësuan elementët e stërvitjes rreshtore, dhënieve të komandave, stërvitjet taktike të luftës pozicionale e ndonjë tjetër. Efekti i repartit të Atlantikut, që njihet edhe si Batalioni "Atlantiku", i ardhur nga ShBA-ja, sipas të dhënave të një informacioni të korrikut 1999, kishte kryer shërbim ushtarak në masën 50%. Ata fillimisht patën probleme me disiplinën ushtarake që e tejkaluan shpejt, ndërsa kishin njohuri të mira për armatimin dhe rezultate të mira në stërvitje taktike dhe në qitje. Në fillimet e çdo dite iu dha përparësi ngritjes së Flamurit dhe këndimit të Himnit Kombëtar. Për të kuptuar sesa shumë vlerësohej nga vullnetarët ngritja dhe prania e Flamurit dhe këndimi i Himnit Kombëtar, mund të thuhet se riti i tyre shoqërohej çdo ditë me duartrokitje dhe emocion. Njëherësh, dukej se ato ceremoni-rituale ndikonin mjaft në gjendjen morale dhe psikologjike të vullnetarëve për t'u stërvitur me zell dhe për t'u monitoruar, për të shkuar sa më parë e të përgatitur në luftën për çlirimin e Kosovës.

Në ditët e para problem përbënin pajisja me uniforma të njëjta, si dhe kundërshtimi i organizimeve mbi bazë krahinore, fisi apo familjare, aq më tepër klanore. Ato prirje u mënjanuan me kujdes nga oficerët që drejtuan organizimin dhe përgatitjen ushtarake të vullnetarëve, duke shpjeguar se në luftë shkohej me organizim ushtarak të kohës dhe jo sipas traditës dhe zakoneve.

Për ta përmbyllur këtë ngjarje me rëndësi u aplikua edhe forma e Betimit Ushtarak dhe nënshkrimi i tij. Kjo ditë u vlerësua shumë nga luftëtarët si një simbolikë e të qenit gati për të shkuar në luftë për lirinë e atdheut – Kosovës!

E gjithë fushata e bombardimeve të NATO-s në bashkëpunim nga toka me forcat e UÇK-së, por edhe me mbështetjen indirekte të Shqipërisë pranë,u përmbyll brenda shtatëdhjetetetë ditëve. Më 9 qershor të vitit 1999, Milloshevigi urdhëroi që ushtria e tij t'i ndalte veprimet, ndërsa u nënshkrua një marrëveshje për tërheqjen e trupave serbo-jugosllave nga Kosova. Në të hynë trupat e NATO-s, kurse krahina tashmë e lirë do të administrohej nga OKB-ja. Shqipëria me institucionet e saj qeveritare kishte luajtur rolin e saj në dobi të bashkëkombëseve të saj në Kosovë si gjatë krizës, ashtu edhe gjatë përgatitjes së forcave të UÇK-së për luftën e çlirimit të Kosovës.

[1] Shiko Jens Reuter: Optionen der internationalen Gemeinschaft zur Lösung der albanischen Frage. (Erstmalig erschienen in:Zur Problematik der Stabilisierung des Westbalkans. Hg. von der Landesverteidigungsakademie Wien und vom Militärwissenschaftlichen Büro. Wien 2000 (=Studien und Berichte zur Sicherheitspolitik 5/2000), S 55-75).
[2] Shih dhe Fred C . Abrahams, Shqipëria e Re, Dudaj, Tiranë, 2015, f.313.
[3] Po aty.
[4] Po aty.
[5] Halil Katana, Kadusi Lama – gjenerali i luftës, Tiranë, 2002.
[6] Reuter, f. 57.
[7] Fred C . Abrahams, f. 312.
[8] Abrahams, f. 326.
[9] Halil Katima, Kudusi Lama, gjenerali i luftës, Tiranë, 2002, f.304.
[10] Abrahams, f. 340

*(Marrë nga libri "Ushtria Çlirimtare e Kosovës, vlerë kombëtare", botuar nga Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës. Kjo kumtesë është paraqitur në sesionin shkencor mbajtur në Prishtinë më 7 mars 2022, organizuar nga: Instituti Albanologjik i Prishtinës, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave e Shqipërisë dhe Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës. Kumtesat e njëzet intelektualëve shqiptarë gazeta "Epoka e re", përpos në portal, do t'i botojë për njëzet ditë me radhë edhe në formatin pdf. Librin mund ta gjeni në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës.)*




Sport




# Maroku eliminon Spanjën, në çerekfinale përballet me Portugalinë





DOHA, 6 DHJETOR - Maroku ka bërë atë që mund të quhet befasia më e madhe e Botërorit të Katarit deri më tani, duke eliminuar Spanjën me penallti në fazën 1/16 dhe duke fluturuar kështu në çerekfinale. 90 minutat u mbyllën 0-0, ndërsa s'pati gol as në shtesa. Të parët që provojnë janë të besuarit e Regragrui me anë të Achraf Hakimi, i cili gjuan bukur nga goditja e dënimit, por pa rezultat. Në minutën e 25-të iberikët nuk përfitojnë dot pas një gabimi në prapavijën e kundërshtarit, gjithsesi asgjë për t'u shqetësuar pasi sinjalizohet pozicion jashtë loje. Pak më pas, Asensio tenton të zgjidhë gjithçka vet, gjen vetëm rrjetën e jashtme. Maroku tregoi edhe në fraksionin e dytë që është një kockë e fortë, sulme dhe kundërsulme, me shpejtësinë e duhur dhe një ide të qartë për lojën iu afrua edhe golit të avantazhit. Shtesa nuk dhuroi asgjë, sakaq portieri i Marokut, Bono i dha kualifikimin ekipit të tij duke kuptuar shumë herë krahun gjatë ekzekutimit të penalltive. Gjithçka e thjeshtë për "Gardianin" e Sevillias, i cili i njeh mirë spanjollët. Portugalia është skuadra e fundit çerekfinaliste. Të besuarit e Fernando Santos eliminuan me shifrat 6-1 Zvicrën. Luzitanët vendosën sfidën në korsinë e duhur që në pjesën e parë me golat e Ramos dhe 39-vjeçarit Pepe. Pjesa e dytë do niste si mos më mirë për portugezët, që thelluan avantazhin, përsëri me lojtarin e Benficas, Ramos. Performanca fantastike për këtë lojtar duket se nuk kishte të ndalur, pasi "tund rrjetën" për të tretën herë, pas golave të Guerrerio dhe Akanji. "Festivali" u përmbyll nga Leao, në 90+. Sa i takon të besuarve të Murat Yakin, Granit Xhaka dhe Xherdan Shaqiri e patën të pamundur të bëjnë diçka në këtë takim, me dy futbollistët shqiptarë që ia dalin të lejnë një shije të mirë në Katar pas paraqitjeve që bënë në grupe.

# Kuka: Trajnerin e Serbisë gati e kapi zemra nga suksesi i sportistëve shqiptarë

PRISHTINË, 6 DHJETOR - Trajneri i xhudos, Driton Kuka, është shprehur jashtëzakonisht i lumtur me suksesin e sportistëve shqiptarë nëpër botë, duke u nisur nga suksesi i fundit i Zvicrës kundër Serbisë në Kampionatin Botëror, aty ku dy futbollistët kosovarë, Xherdan Shaqiri dhe Granit Xhaka, ishin protagonistët kryesorë. Nëpërmjet një postimi në "Facebook", Kuka ka thënë se edhe në sport ka politikë dhe se mund të shihet në çdo garë të madhe. Ai ka thënë se shqiptarët gjithandej nëpër botë po tregojnë vlera e kjo po sjell situata si të atij shumë të rënda për kundërshtarët, siç ishte situata me trajnerin e Serbisë. "Euforia kaloi. Ndeshja ku protagonistë ishin futbollistët shqiptarë përfundoi ashtu siç ne dëshiruam. Na kënaqën zemrat. Ju lumtë shqipe! Sporti ka edhe politikë. Kjo tashmë është bërë ashiqare në çdo garë të madhe sportive. Provokime ka në çdo ndeshje, në çdo sport. Me qëllime nga më të ndryshmet. Analizë për ngjarjet sportive sa ma pak njerëzit që janë laikë, edhe nuk dinë e shpesh ia huqin se nuk kuptojnë mirë se çfarë emocione ka. Shqiptarët këndej në trojet tona, por edhe gjithandej nëpër botë, po tregojnë vlera e kjo po sjell situata si të atij trajnerit të pistë që gati e kapi zemra", ka shkruar Kuka.




# Taulant Xhaka, Avdiut: Nuk paske aspak gjak shqiptari



CYRIH, 6 DHJETOR - Vëllai i Granit Xhakës, Taulant Xhaka, ka reaguar ndaj analistes Zana Avdiu, pasi ajo e quajti të turpshëm veprimin e Xhakës në ndeshjen në mes të Zvicrës dhe Serbisë. Përmes një postimi në "Instagram", Taulanti ka reaguar ashpër ndaj Avdiut, duke ia sqaruar ngjarjen në tri pika të shkurtra. Në postimin e Taulantit ai pretendon se Zana është e paguar nga dikush, ndërsa Granitin e ka quajtur shembull për të gjithë shqiptarët. "Ti Zana Avdiu a qysh e pate emrin! Ti pika e parë nuk ke lidhje as me futboll! Pika e dytë ti nuk ke lidhje çka ndodh në një fushë futbolli e çfarë emocione ka aty brenda! Pika e tretë ti nuk e njeh aspak familjen Xhaka edhe historinë e babait tim dhe familjes Xhaka. Unë nuk di kush të ka paguar me dal aty e me thonë kësi sene banale. Edhe prapë del në intervista e fol për kërcënime. Granit është shembull për krejt shqiptarët në aspektin pozitiv dhe ti e quan rrugaç. Marre, se nuk paske aspak gjak shqiptari ti!", ka shkruar Taulant Xhaka.

## Sokol Kiqina ndahet me Llapin

PODUJEVË, 6 DHJETOR - Skuadra e Llapit ka filluar me ndryshime, pasi rezultatet e gjertanishme nuk kanë qenë ato se janë pritur. Klubi nga Podujeva ka njoftuar se me marrëveshje të dyanshme nga ky klub është larguar sulmuesi Sokol Kiqina. "KF Llapi njofton se me marrëveshje të dyanshme kanë rënë dakord për mbylljen e bashkëpunimit me sulmuesin Sokol Kiqina. Kiqina u bashkua me ne gjatë kësaj vere nga FC Feronikeli dhe u paraqit në 10 ndeshje zyrtare me klubin tonë. Klubi ynë e falënderon për kontributin e dhënë dhe i dëshiron suksese në vazhdim të karrierës! Suksese Kiqo!", thuhet në njoftimin e Llapit.



## FBK-ja: Stop dhunës në basketboll




**Prishtinë, 6 dhjetor** - Nga 7 deri në 11 dhjetor do të zhvillohet Superkupa e Kosovës në basketboll në kryeqytet. Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) në bashkëpunim me Policinë e Kosovës dhe organizatorët i kanë marrë të gjitha masat për sigurinë e të gjithë të pranishmëve në palestër. FBK-ja u bën thirrje të gjithë adhuruesve të basketbollit që t'i përkrahin klubet e tyre të zemrës dhe jo të shfaqin dhunë në palestra. "Presim që Superkupa të jetë spektakël i basketbollit dhe jo i dhunës", thuhet në njoftim e FBK-së.

# Neymari: Kam qarë pa fund pas lëndimit, tash e dua titullin



**Doha, 6 dhjetor** - "Pokeri" i Brazilit solli për tifozët pak aromë futbolli të bukur, futboll bio, lojë të shpejtë, futboll sulmues. Sigurisht që Koreja e Jugut ia bëri pak gjërat më të lehta, nuk ishte në nivelin e duhur për ta përballuar Neymarin me shokë të cilët ishin shpërthyes që në pjesën e parë duke realizuar 4 gola brenda 36 minutash. Të gjithë në radhët e pesë herë kampionëve të botës ishin në formë fantastike, madje edhe vetë trajneri Tite i cili festoi së bashku me lojtarët. Fjalët e tij të para në konferencë për shtyp shkuan pikërisht për Neymarin. "Kur një skuadër dëshiron të sulmojë, të luajë në atë mënyrë, është më e qetë kur ka një lojtar si Neymar, i cili është i aftë ta bëjë dallimin, një lojtar që ka karakteristikat e një lideri. Të gjithë kanë karakteristika të ndryshne, por Neymari është në qendër. 18 raste, 10 gjuajtje në kuadrat? Në sfida të tilla është shumë i rëndësishëm ekuilibri, nëse e humbet për një moment, mundësia për të gabuar rritet ndjeshëm", u shpreh Tite. "Ka ardhur ora të shohim larg. Ëndrra jonë është të fitojmë titullin, por duhet të vijojmë hap pas hapi. Kjo ishte ndeshja e katërt. Na duhen edhe tri të tjera. Jemi në rrugën e duhur, të përqendruar në maksimum për të fituar këtë titull", u shpreh Neymari duke u rikthyer te dëmtimi i pësuar që mund të rezultonte fatal: "Kisha shumë frikë pasi në këtë Botëror erdha në kushte perfekte, pas një fillimisezoni shumë të mirë. Ky dëmtim më bëri të vuaj jo pak. Kam kaluar të gjithë natën duke qarë me familjen time. Në fund ia vlejti e gjithë kjo sakrificë".

# Golden State rikthehet te fitorja



**REZULTATET**

| | |
|---|---|
| Charlotte - Clippers | 117-119 |
| Orlando - Milwaukee | 102-109 |
| Atlanta - Oklahoma | 114-121 |
| Toronto - Boston | 110-116 |
| Houston - Philadelphia | 132-123 |
| Memphis - Miami | 101-93 |
| Dallas - Phoenix | 130-111 |
| Golden State - Indiana | 104-112 |

**San Francisco, 6 dhjetor** - Kampionët e Golden States fituan me rezultat 112-104 ndaj Indianas, një ndeshje e vendosur në periodën e fundit. Klay Thompson me 28 pikë e Jordan Poole me 23 ishin dy më të mirët për Warriorsin. Në sekondat e fundit fiton ekipi i clippersave, që mundi Charlotten (119-117) jashtë fushës, sfidë ku u dallua Paul George me 19 pikë. Fitore të vështirë korr edhe Milwaukee, që mundi me rezultat 109-102 Orlandon, me të zakonshmin Antetokounmpo protagonist, me 34 pikë e 14 rebounde. Pas dy kohëve shtesë fiton skuadra e Houstonit, që mundi Philadelphian (132-123). Joel Embiid realizoi 39 pikë për miqtë, por që s'mjaftuan, ndërsa Green e Porter realizuan 51 pikë së bashku për teksanët.

## SHKURT

### Tucheli mund të zëvendësojë Flickun

Ish-trajneri i Chelseat, Thomas Tuchel, është favorit për ta marrë drejtimin e Gjermanisë nëse trajneri aktual Hans-Dieter Flick largohet. Këtë e bën me dije edicioni gjerman i "Kicker". Shkarkimi i Oliver Bierhoff si menaxher i përgjithshëm i Gjermanisë mund të ndikojë në të ardhmen e Flickit me ekipin, sipas një burimi. Në sfondin e këtij lajmi, Hans-Dieter, mund ta japë dorëheqje. Thomas Tuchel është pa punë pasi u shkarkua nga Chelsea në fillim të shtatorit. Thomas më parë ka qenë i përfolur për të punuar për Anglinë, ku gjermani mund të zëvendësojë Gareth Southgate.

### Si do të ndalet Messi? Përgjigjet Van Gaali

Holanda në çerekfinale të Kupës së Botës do të përballet me Argjentinën. Leo Messi është duke shkëlqyer me Argjentinën, ndërsa trajneri holandez Louis van Gaal nuk ka dhënë një përgjigje të prerë sesi do të ndalet shtatë herë fituesi i "Topit të Artë". "Do ta shihni të premten, sepse tani s'mund t'jua zbuloj këtë", ka thënë Van Gaali.

### Brozoviqi vendos rekord në Kupën e Botës

Marcelo Brozoviq ka vendosur një rekord të ri në Katar 2022. Në ndeshjen me Japoninë, të cilën Kroacia e fitoi vetëm pas penalltive dhe siguroi fazën e çerekfinaleve, performanca që bie më shumë në sy është ajo e Brozoviqit. Kroati ka vendosur një rekord të ri, duke thyer shifrat e vendosura po nga ai, por në Botërorin "Rusi 2018". Në 90 minuta në fushë e lojë dhe së bashku me kohën shtesë kroati përshkoi 16.7 kilometra, nga 16.33 që kishte bërë në Rusi katër vjet më parë.

### Sterling: Nuk do të kthehem në Katar nëse familja ime nuk është e sigurt

Raheem Sterling nuk ka ndër mend të kthehet në Kupën e Botës në Katar nëse familja e tij nuk është plotësisht e sigurt në Angli. "Marca" spanjolle citon një burim nga "Sun", i cili kishte kontakte me sulmuesin e Chelseat, duke theksuar se nuk ka ku të shkojë nëse dhe për sa kohë që familja e tij nuk është në një mjedis 100 % të sigurt.

### Red Bulli: Kemi më shumë frikë nga Mercedesi sesa nga Ferrari

Skuadra e Red Bullit i fitoi të gjitha titujt e këtij sezoni në Formula 1. Helmut Marko, një nga drejtuesit e makinës austriake, shprehet se për sezonin e ri ai i trembet më shumë Mercedesit sesa Ferrari, pavarësisht se këtë sezon dueluan pikërisht me "kokëkuqen" për titullin kampion. "Mbyllëm një sezon të jashtëzakonshëm, por jo të përkryer. Kemi ende mundësi për t'u përmirësuar. Ferrari është një rival i fortë, por Mercedesi do të jetë edhe më shumë. Madje mendoj se do të kemi më shumë rivalitet me Mercedesin sesa me Ferrarin", ka thënë Helmut Marko. "Gjithsesi, ne jemi favoritë dhe mendoj se do të kemi një avantazh karshi rivalëve vitin tjetër. Mercedesi rikuperoi mjaft në fund të këtij viti dhe do të ketë më shumë kohë në galerinë e erës sesa ne pas penalizimit. Ndërsa ne kemi pilotin më të mirë, ndërkohë që Leclerc e Hamiltoni janë në gjysmën e rrugës", tha Marko.

Në bazë të nenit 21 paragrafi 21.4 e Ligjit për Ndërmarrje Publike Nr.03/L-087, si dhe Plotesim Ndryshimi i Ligjit mbi NP Nr.04/L-111, si dhe Kodi Etikes dhe Qeverisjes Korporative, Bordi i Drejtorëve të KRM "Pastrimi"SHA-Prishtinë, në mbledhjen e mbajtur me 30.12.2022, vendosi të publikoi ketë:

**K O N K U R S**
**Për plotësimin e pozitës**:

**Kryeshef Ekzekutiv i Kompanisë**
**I përgjigjet:** Bordit të Drejtorëve.
**Vendi i Punës:** Prishtinë

**Paga:** Në pajtim me politikën e kompensimit të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve.
**Kohëzgjatja e emërimit:** Mandati për pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv është 3 vjeçar.

**Detyrat dhe përgjegjësit kryesore:**

- Të menaxhoj kompaninë në baza ditore në pajtim me aktet ligjore dhe politikat e kompanisë,
- Të zbatojë qëllimet strategjike dhe objektivat e kompanisë duke i dhënë drejtim lidershipi drejt arritjes së misionit dhe vizionit të kompanisë,
- Mbështet punën e Bordit të Drejtorëve me anë të propozimeve lidhur me politikat dhe vendimet që do t`i merr Bordi;
- Është përgjegjës për shërbimet që ofron kompania duke mbikqyrë kualitetin e programit të përgaditjes së shërbimeve, marketingun dhe shitjen e këtyre shërbimeve,
- Propozon buxhetin vjetor për aprovim të Bordi i Drejtorëve, si dhe me kompetencë menaxhon resurset financiare të kompanisë brenda ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme,
- Në mënyrë efektive menaxhon resurset njerëzore të kompanisë brenda politikave zyrtare të kompanisë dhe procedurave konform ligjeve në fuqi,
- Siguron që misioni dhe programi i Kompanisë dhe i shërbimeve të saj, të jenë në mënyrë të vazhdueshme dhe fuqishëm të prezantuara për të krijuar një pasqyrim pozitiv të komapnisë të palët e interesit,
- Mbikqyrë ngritjen e fondeve, planifikimin dhe zbatimin e tyre, duke përfshirë identifikimin e burimeve të financimit, si dhe përgaditjen e strategjisë për të i`u qasur këtyre burimeve duke ofruar propozim për administrimin dhe dokumentimin e ngritjes së këtyre fondeve,
- Menaxhon politika dhe zbaton vendimet e Bordit në pajtim me legjislacionin në fuqi.

**Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:**

Bordi i Drejtorëve dëshiron të sigurohet që të gjithë kandidatët potencial të jenë persona me integritet të njohur të cilët i plotësojnë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1, si dhe plotësojnë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2 pikat (d), (f), (k) dhe (l) të Ligjit për Ndërmarrje Publike dhe kanë përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar për pozitën në fjalë.

Përveç kushteve të përgjithshme, kandidatët duhet të plotësojnë edhe këto kushte të vecanta:

- të kenë diplome universitare nga fusha ekonomike, juridike, teknike, shoqerore ose te ngjajshme.
- të kenë pervoje profesionale përfshirë së paku 5 vjet në nivelin drejtues në insitucione shtetërore ose ndërmarrje publike
- të kenë integritet të lartë moral e profesional,
- të kenë aftësi të dëshmuara në udhëheqje ose menaxhim,
- njohja e gjuhëve të huaja do të ketë përparësi,
- të mos jenë të dënuar ose nën hetime.

Aplikacionit per poziten e KE-se duhet bashkangjitur edhe këto dokumente:

- CV-ne (Biografine),
- Kopjen e leternjoftimit,
- Planin personal zhvillimor strategjik te ndermarrjes per 3 vitet e ardheshme
- Letër motivimin,
- Deklaraten nën betim
- Diplomën e fakultetit - kopje,( e noterizuar )
- Certifikaten qe nuk është nën hetime .

**Aftësitë, përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen:**

Duhet të kenë shkathtësi në përcaktimin dhe arritjen e objektivave strategjike të ndermarrjes, aftësi të larta organizative dhe drejtuese, aftësi të shkëlqyeshme të komunikimit dhe negocimit, aftësi të dëshmuara për analizën e gjendjes dhe ofrimin e opsioneve, njohuri bazike në programet e kompjuterit, përvojë 5 vjet në nivelin drejtues dhe në fusha që ndërlidhen me menaxhim te institucioneve apo ndermarrjeve publike, njohja e gjuhëve të huaja është e dëshiruar.

**Data e mbylljes së konkursit:**
Konkursi është i hapur 30 ditë kalendarike nga dita e publikimit.

**Procedura për aplikim:** Aplikacioni merret në Kompani, të njëjtit i bashkangjiten dokumentet deklarata nen betim , kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, të diplomuarit në universitetet jashtë vendit t'ia bashkëngjisin dëshminë e nostrifikimit të diplomës, dëshminë për përvojën, dëshminë se nuk janë nën hetime apo te dënuar për vepër penale dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme, që kërkohen për vendin e punës.

Rruga Tahir Zajmi p.n., Prishtinë
Tel + 383 38 603 191,
www.pastrimi.org
E-mail: info@pastrimi.org

## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Electro 02" SH.P.K. Mitrovicë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811489302 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Electro 02" D.O.O. Mitrovicu donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811489302 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "Electro 02" L.L.C. Mitroviva has come to the decision to quit its business: 811489302 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Exillent" SH.P.K. me pronar Bajram Kovaqi, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810127458 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Exillent" D.O.O. Bajram Kovaqi, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810127458 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "Exillent" L.L.C. Bajram Kovaqi, has come to the decision to quit its business: 810127458 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

"HORTIKULTURA" SH.A.
Nr. 3445
Dt. 07. 12. 2022
PRISHTINË

# Hortikultura

NDËRMARRJA PUBLIKE KOMUNALE PËR PROJEKTIMIN, MIRËMBAJTJEN DHE NDËRTIMIN E SIPËRFAQEVE TË GJELBËRTA

Në bazë të dispozitave të nenit 5, paragrafit 5.2, të nenit 16 të Ligjit nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", me 31/15 qershor 2008), Vendimit të Kuvendit të Komunës dhe Vendimit të Kryetarit të Kryetarit të Komunës për emërimin e anëtarëve të Komisionit komunal të aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Komunale "Hortikultura" Sh. A. Prishtinë, komisioni komunal i aksionarëve në mbledhjen e mbajtur me 06.12.2022, mori vendimin për shpalljen e:

## KONKURSIT PUBLIK

- **Për zgjedhjen e 4 anëtarëve në Bordin e Drejtorëve të NPL "Hortikultura" Sh. A. Prishtinë**

- DREJTORËT E BORDIT TË NDËRMARRJES PUBLIKE KOMUNALE, NUMRI DHE MANDATI I TYRE

- Ndërmarrja Publike Komunale "Hortikultura" Sh. A., Prishtinë – 4 drejtorë;
- Mandati i drejtorit të zgjedhur nga ana e Komisionit Komunal të Aksionarëve është tri (3) vjet.

- KOMPENSIMI I DREJTORËVE TË NPK'' HORTIKULTURA'' SH.A. PRISHTINË

- Kompensimi i drejtorëve të bordit të NPK do të bëhet në pajtim me dispozitat e nenit 20, paragrafi 20.2 të Ligjit për ndërmarrjet publike.

- KUALIFIKIMET DHE PËRGATITJA PROFESIONALE

- Sipas nenit 17, pika 71.3 të Ligjit për ndërmarrjet publike, një kandidat për t'u zgjedhur drejtor në Bordin e drejtorëve të NPK duhet t'i plotësojë këto kushte:
- të jetë person që ka integritet të njohur, duke marrë parasysh, ndër tjera, çfarëdo shkelje materiale të detyrave fiduciare që mund të ketë bërë ky person ndaj cilitdo person tjetër;
- të ketë përgatitje superiore;
- duhet ose (i) të ketë së paku pesë (5) vite përvojë
- së paku në një nivel të lartë të menaxhmentit në fushën e administrimit të biznesit, financave korporative, financa, menaxhim i thesari, banka, konsulencë në biznes ose industri ose nga një fushë tjetër e shkencës ose njohurisë e cila ka të bëjë me veprimtarinë afariste të NP-së; ose (ii) për së paku pesë (5) vite, të ketë qenë kontabilist publik, jurist i kualifikuar, ose anëtar i kualifikuar i një profesioni tjetër i cili ndërlidhet ngusht me veprimtarinë afariste të NP-së.

- KUSHTET

- Kandidati ka të drejtë të zgjidhet në Bordin e NPK "Hortikultura", nëse:
- nuk ka qenë i dënuar dhe nuk është nën hetime nga një gjykatë kompetente;
- nuk ka shkelur kodin etik, apo standardet e sjelljes profesionale, përveç nëse një dënim i tillë është ndryshuar nga një gjykatë ose organ tjetër i ankesave;
- nuk ka bërë përgënjeshtrime materiale nën çfarëdo dëshmie nën betim;
- nuk ka qenë në post menaxhues të ndonjë kompanie që ka falimentuar gjatë dhjetë (10) vjetëve të fundit.
- Kandidati nuk mund të zgjidhet drejtor në Bordin e NPL "Hortikultura", nëse:
- aktualisht është zyrtar (në kuptim të nenit 21 të Ligjit për Ndërmarrjet publike), menaxher i ndërmarrjes përkatëse, ose cilësdo nga filialet e saj;
- ka shërbyer si menaxher i ndërmarrjes publike përkatëse, ose cilësdo nga filialet e saja brenda pesë (5) vjetëve të kaluara;
- aktualisht ka, ose gjatë tri (3) viteve të kaluara ka pasur çfarëdo marrëdhënie materiale afariste (përveç si konsumator individual i shërbimit të ndërmarrjes publike) me ndërmarrjen publike përkatëse, ose cilëndo nga filialet, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë, ose të tërthortë;
- është aksionar, drejtor ose zyrtarë, në një shoqëri tregtare ose person tjetër juridik, i cili ka marrëdhënie materiale afariste me ndërmarrjen publike përkatëse;
- pranon, ose ka pranuar brenda tri (3) viteve të kaluara kompensimin shtesë nga ndërmarrja publike përkatëse, ose nga cilado filialë e saj (përveç honorarit të drejtorit ose kompensimin stimulues të përcaktuar në nenin 20 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, ose është anëtar në skemën pensionale të ndërmarrjes publike përkatëse, ose të cilësdo nga filialat e saja;
- përfaqëson një aksionar, i cili posedon mbi dhjetë përqin (10%) të aksioneve votuese në ndërmarrjen publike përkatëse.;
- ka shërbyer në Bordin e drejtorëve të ndërmarrjes publike përkatëse, më shumë se nëntë (9) vite nga dita e parë e zgjedhjes së tij;
- është i afërm i shkallës së tretë (siç është konstatuar në përputhje me përkufizimin e interesit financiar në nenin 2 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike), i cilitdo person që i takon cilësdo nga kategoritë e sipërmendura; -
- është zyrtar, drejtor ose aksionar, ose ka një interes financiar në një shoqëri tregtare që konkurron me ndërmarrjen, ose është një menaxher i lartë zyrtar, drejtor ose aksionar ( i cili posedon më shumë se dy përqind (2%) të të drejtave të votimit), ose ka një interes të konsiderueshëm financiar në cilëndo nga shoqëritë tregtare që konkurrojnë në ndërmarrjen;
- është, ose në çfarëdo kohe gjatë periudhës 36 mujore para datës së aplikimit, ka qenë zyrtar i zgjedhur, i emëruar politik, ose bartës i një posti udhëheqës ose vendimmarrës, në një parti politike,
- ka çfarëdo konflikti të interesave që, për nga natyra, do të shkaktonte që ky person të mos jetë në gjendje që në mënyrë efektive, me besnikëri, në mënyrë të pavarur dhe objektive t'i përmbushë detyrat e tij përgjegjëse ndaj aksionarëve dhe ndërmarrjes publike.
- nuk punon në ndonjë institucion ku bëhen politikat zhvillimore për Nndërmarrje publike përkatëse ku kandidati punon.

INFORMATË PËR PROCEDURËN E KONKURIMIT

Kandidatët për drejtor në Bordin e drejtorëve të NPK"Hortikultura", duhet t'i dorëzojnë provat e mëposhtme:

- CV-në,
- Letër motivimi,
- Deklaratën nën betim (formular, i cili plotësohet në momentin e dorëzimit të dokumentacionit),
- Dëshminë mbi përvojën e punës,
- Certifikatën që nuk është nën hetime dhe
- Certifikatën e shtetësisë së Kosovës.

Aplikuesi duhet të përgatisë deklaratën nën betim, në të cilin deklaron se ai/ajo i përmbush kushtet e kualifikimit; pavarësinë dhe përgatitjen profesionale. Çdo përgënjeshtrim material, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca, ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër përmendur, do të rezultojë me diskualifikimin e menjëhershëm.

- Data e shpalljes së Konkursit : 07.12.2022 deri me dt.06.01.2023

- Aplikacionet merren dhe dorëzohen në adresën Rr. Tahir Zajmi p. 2., objekti I Zjarrëfiksëve, në Arkivën e ndërmarrjës.
- Në aplikacion duhet te ceket qartë titulli i vendit te punës dhe dokumentet e bashkangjitura aplikacionit duhet te jenë kopje dhe nuk kthehen.
- Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.
- Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen.
- Konkursi mbetet i hapur 30 ditë kalendarike nga dita e shpalljes.

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Petrit Rakoci nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë Auto Mekanik.

- Newco Agromorava L.L.C. Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara me nr. Unik Identifikues 810510835 bënë shpalle në gazetë për zvogëlim të kapitalit nga 216,750.00€ në zero euro (0 ).

- Hekuran Krasniqi nga Demjani KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë SH.F.M.U. kongresi manastirit Demjan KK Gjakovë nga kl. I-V dhe nga kl. VI-IX.

- Kujtese Kokalla nga Cermjani KK Gjakovë shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Amet Kryeziu shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - V shfmu " Dëshmorët e Zhurit " Zhur.

- Kastriot Mucaj shpall te pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.

- Elvis Susuri shpall te pavlefshme diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.

- Eldina Bajsini shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.

- Burim Fazliu ( Krasniqi ) shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

- Andi Shefqeti shpall te pavlefshme diplomën dhe vërtetimin e lëshuar për gjendjen e notave dhe mungesave shmlt "11 Marsi " Prizren.

- Redon Mazreku shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI- IX shfmu " Ibrahim Fehmiu " Prizren.

- Edison Mazreku shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI- IX shfmu " Ibrahim Fehmiu " Prizren.

- Albnor Ibrahimi shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI- IX shfmu " Ibrahim Fehmiu " Prizren

- Albina Dumnica B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330445842.

- Agron Merovci nga Vushtrria shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës së mesme Bujqësore tash "Avdyl Frashëri" drejtimi Veterinë.

- Sahit Kurhasku nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e SH.F. "Ali M. Hasi" Crmjan KK Gjakovë nga kl.I-VII.

"HORTIKULTURA" SH.A.
Nr 3445
Dt 07. 12. 2022
PRISHTINË

Na osnovu odredbi člana 5, stav 5.2, člana 16 Zakona br. 03/L-087 za javna preduzeća („Službeni list Republike Kosovo", od 31/15. juna 2008. godine), Odluka Skupštine opštine i Odluka predsednika opštine o imenovanju članova Opštinska komisija akcionara za preduzeće Javno opštinsko „Hortikultura" Š. A. Priština, opštinska komisija akcionara na sednici održanoj 06.12.2022, donela je odluku da objavi:

JAVNI KONKURS

- Za izbor 4 člana u Upravni odbor NPL „Hortikultura" Š. ODGOVOR: Priština

- DIREKTORI ODBORA JAVNOG KOMUNALNOG PREDUZEĆA, NJIHOVI BROJ I MANDAT

- Opštinsko javno preduzeće „Hortikultura" Š. A., Priština – 4 direktora;
- Mandat direktora kojeg bira Opštinska komisija akcionara je tri (3) godine.

- NAKNADA DIREKTORA NPK'' HORTIKULTURA'' SHA.A. Priština

- Naknada direktora odbora NPK vršiće se u skladu sa odredbama člana 20. stav 20.2. Zakona o javnim preduzećima.

- KVALIFIKACIJE I STRUČNA OBUKA

- Prema članu 17. tačka 71.3 Zakona o javnim preduzećima, kandidat za izbor direktora u Upravnom odboru NPK mora da ispunjava sledeće uslove:
- da bude osoba poznatog integriteta, uzimajući u obzir, između ostalog, svaku bitnu povredu fiducijarnih dužnosti koju je to lice moglo počiniti prema bilo kom drugom licu;
- imaju vrhunsku pripremu;
- mora ili (i) imati najmanje pet (5) godina iskustva
- najmanje na visokom nivou menadžmenta u oblasti poslovne administracije, korporativnih finansija, finansija, upravljanja trezorom, bankarstva, konsaltinga u poslovanju ili industriji ili iz druge oblasti nauke ili znanja vezanih za poslovnu delatnost NP; ili (ii) najmanje pet (5) godina, da je bio javni računovođa, kvalifikovani advokat ili kvalifikovani član druge profesije koja je usko povezana sa poslovnom aktivnošću JP.

- USLOVI

- Kandidat ima pravo da bude biran u UO NPK „Hortikultura", ako:
- nije osuđivan i nije pod istragom nadležnog suda;
- nije prekršio etički kodeks, niti standarde profesionalnog ponašanja, osim ako je tu kaznu izmijenio sud ili drugi žalbeni organ;
- ni pod kojim svedočenjem pod zakletvom nije davao materijalne pobijanja;
- nije bio na rukovodećoj poziciji nijednog preduzeća koje je otišlo u stečaj u poslednjih deset (10) godina.
- Kandidat ne može biti biran za direktora u UO NPL „Hortikultura", ako:
- je trenutno funkcioner (u smislu člana 21. Zakona o javnim preduzećima), rukovodilac odgovarajućeg preduzeća, ili nekog njegovog zavisnog preduzeća;
- da je bio direktor relevantnog javnog preduzeća, ili bilo koje njegove podružnice u proteklih pet (5) godina;
- ima trenutno, ili tokom protekle tri (3) godine, imao bilo kakav materijalni poslovni odnos (osim kao individualni potrošač usluga javnog preduzeća) sa odgovarajućim javnim preduzećem, ili bilo kojim od zavisnih preduzeća, direktno ili indirektno;
- je akcionar, direktor ili funkcioner u privrednom društvu ili drugom pravnom licu, koje je u materijalnom poslovnom odnosu sa odgovarajućim javnim preduzećem;
- prihvati, ili je prihvatio u protekle tri (3) godine, dodatnu naknadu od dotičnog javnog preduzeća, ili od bilo kog njegovog zavisnog preduzeća (osim honorara direktora ili stimulativne naknade definisane članom 20. Zakona o javnim preduzećima, ili je član penzionog plana relevantnog javnog preduzeća, ili bilo koje njegove podružnice;
- predstavlja akcionara koji poseduje preko deset odsto (10%) akcija sa pravom glasa u relevantnom javnom preduzeću;
- služio je u Upravnom odboru dotičnog javnog preduzeća više od devet (9) godina od prvog dana njegovog izbora;
- je srodnik trećeg stepena (kako je utvrđeno u skladu sa definicijom finansijskog interesa iz člana 2. Zakona o javnim preduzećima), bilo kog lica koje pripada nekoj od gore navedenih kategorija; -
- je funkcioner, direktor ili akcionar, ili ima finansijski interes u komercijalnom društvu koje se takmiči sa preduzećem, ili je viši menadžer, funkcioner, direktor ili akcionar (koji poseduje više od dva odsto (2%) prava glasa ), ili ima značajan finansijski interes u bilo kojoj od komercijalnih kompanija koje se takmiče u preduzeću;
- je, ili u bilo kom trenutku tokom perioda od 36 meseci pre datuma podnošenja zahteva, bio izabran funkcioner, politički imenovani ili nosilac rukovodstva ili funkcije odlučivanja u političkoj stranci,
- postoji bilo kakav sukob interesa koji bi po svojoj prirodi doveo do toga da ovo lice ne bude u stanju da efikasno, verno, nezavisno i objektivno ispunjava svoje obaveze prema akcionarima i javnom preduzeću.
- ne radi ni u jednoj ustanovi u kojoj se kreiraju razvojne politike za relevantno javno preduzeće u kojem kandidat radi.

PODACI O PROCEDURU KONKURSA

Kandidati za direktora u Upravnom odboru NPK „Hortikultura" moraju dostaviti sledeće dokaze:
- SI-VI,
- Motivaciono pismo,
- Izjava pod zakletvom (obrazac, koji se popunjava u trenutku podnošenja dokumentacije),
- dokaz o radnom iskustvu,
- Potvrda koja nije pod istragom i
- uverenje o državljanstvu Kosova. Podnosilac zahteva mora da pripremi izjavu u kojoj izjavljuje da ispunjava kvalifikacione uslove; samostalnost i stručno usavršavanje. Svako materijalno falsifikovanje, bilo namerno ili iz nemara, ili materijalna promena u odnosu na informacije date u gore pomenutoj izjavi, rezultiraće trenutnom diskvalifikacijom.

- Datum objavljivanja Konkursa: 07.12.2022. do 06.01.2023.

- Prijave se primaju i predaju na adresu Rr. Tahir Zajmi b. 2., objekat Vatrometa, u Arhivu preduzeća.
- Naziv radnog mesta mora biti jasno naveden u prijavi i dokumenti priloženi uz prijavu moraju biti kopije i ne vraćati se.
- Prijave podnete nakon roka se ne prihvataju i nepotpune prijave se odbijaju.
- Biće kontaktirani samo kandidati koji uđu u uži izbor.
- Konkurs ostaje otvoren 30 kalendarskih dana od dana objavljivanja.







MEKA
HALAL FOOD
pashtetë pule
gluten free
100 % mish pule
cilësi e garantuar
pa konservues


ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
(Listed in alphabetical order)
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1905
0.5L